



|   |            |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA           |            |
| QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA               |            |
| MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH |            |
| Njësia Org.<br>Org. Jedinica<br>Org Unit                          | 01         |
| Nr. Prot.<br>Broj Prot.<br>Prot.No                                | 05-6743    |
| Nr. faqeve<br>Br. stranica<br>No. pages                           | -140-      |
| Data:<br>Datum:<br>Date:  | 19/12/2022 |
| Prishtinë / a   |            |

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 176/XII/2022

Datë: 19.12.2022

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr.02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ( 08.06.2020), nxjerr:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet Programi për Sëmundje ngjitëse dhe plani i veprimit
- II. Shtojce e këtij vendimi është Programi për Sëmundje ngjitëse dhe plani i veprimit.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Dr. Dafina Gexha-Bunjaku  
UD Ministër i Shëndetësisë

**Vendim i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti ligjor;
- Arkivës të MSh.



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada – Government*

**Ministria e Shëndetësisë – Ministerstvo Zdravstva – Ministry of Health**

# **PROGRAMI PËR SËMUNDJE NGJITËSE 2023-2032**

**Prishtinë 2022**

## **PËRMBAJTJA**

|   |    |
|---|----|
| <b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....                            | 4  |
| <b>2. HYRJE</b> .....   | 6  |
| <b>3. METODOLOGJIA</b> .....                                      | 8  |
| <b>4. SFONDI</b> .....  | 10 |
| <b>5. OBJEKTIVAT</b> .....  | 38 |
| <b>6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT</b> ..... | 39 |
| <b>7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL</b> .....    | 41 |
| <b>8. SHTOJCA 1 - PLANI I VEPRIMIT</b> .....                      | 41 |

## Shkurtesat

|          |  |
|----------|--|
| AwaRe    | Access, Watch and Reserve  |
| CAESAR   | Central Asian and European Surveillance of Antimicrobial Resistance    |
| DDD      | Doza e Definuar Ditore   |
| EARS-Net | European Antimicrobial Resistance Surveillance Netëork                 |
| ECDC     | Qendra Evropiane për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse |
| EUCAST   | The European Committee on Antimicrobial Susceptibility Testing         |
| GLASS    | Global Antimicrobial Resistance and Use Surveillance System            |
| GNKRA    | Grupi Ndërsektorial për Kontrollin e Rezistencës Antimikrobike         |
| IKShPK   | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës                   |
| ISh      | Inspektorati shëndetësor   |
| KDSh     | Kujdesi Dytësor Shëndetësor  |
| KPSh     | Kujdesi Parësor Shëndetësor  |
| KTSh     | Kujdesi Tretësor Shëndetësor   |
| MF       | Ministria e Financave  |
| MSh      | Ministria e Shëndetësisë   |
| NEQAS    | Netëork of External Quality Assurance Services                         |
| NGS      | Next Generation Sequencing   |
| OBSH     | Organizata Botërore e Shëndetësisë                                     |
| OJQ      | Organizata Joqeveritare  |
| PRK      | Plani i reagimit kombëtar  |
| QKMF     | Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare                                  |
| QKUK     | Qendra Klinike Universitare e Kosovës                                  |
| QMF      | Qendra e Mjekësisë Familjare   |
| QRShP    | Qendrat regjionale të shëndetit publik                                 |
| TAR      | Terapia antiretrovirale  |
| UA       | Udhëzim Administrativ  |

## 1.PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 në kuadër të objektivës strategjike “ruajtja dhe përparimi i shëndetit”, i jep prioritet parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse, përmes hartimit të Programit për sëmundje ngjitëse 2022-2032. Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të këtij Programi është realizuar në koordinim me Qendrën Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve (QEKS/ECDC). Po ashtu, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) në kapitullin 28 “Konsumatori dhe mbrojtja e shëndetit publik”, përfshihet edhe parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve ngjitëse, si një ndër prioritetet kryesore.

Në kuadër të kornizës më të gjerë të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian, duke qenë se Kosova është një vend kandidat potencial për anëtarësim, vlerësimi teknik është kryer me kërkesë e Komisionit Evropian (KE) dhe në marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës. ECDC ka punuar me Ministrinë e Shëndetësisë së Kosovës (MSh) dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKShPK) për të përgatitur vlerësimin teknik, i cili u realizua më 22-26 Tetor 2018.

Objektivat kryesore të vlerësimit ishin:

- Vlerësimi i progresit në zbatimin e legjislacionit të BE-së për sëmundjet ngjitëse, bazuar në kapacitetin adekuat administrativ dhe institucional dhe verifikimi i qëndrueshmërisë së sistemit të mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj sëmundjeve ngjitëse, duke marrë parasysh burimet njerëzore dhe financiare të Kosovës;
- Identifikimi i fushave për forcimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit të kontrollit të sëmundjeve ngjitëse të vendit dhe mbështetja për fuqizimin e sistemit, duke përgatitur kështu Kosovën për pjesëmarrje efektive në aktivitetet e BE/ECDC, duke përfshirë rrjetet e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse të BE-së.

Raporti i cili ka shërbyer si referencë kryesore për hartimin e Programit është “*Assessment of capacity development, health governance, surveillance, preparedness and response in the field of communicable diseases*” i realizuar nga ECDC në vitin 2018, dokument ky i cili identifikon sfidat e sistemit të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë dhe ofron rekomandimet për përmirësim e këtij sistemi.

Para se të bëhej vlerësimi, ekspertët në Kosovë plotësuan një pyetësor të detajuar të vetëvlerësimit, që mbulonte sistemin e sëmundjeve ngjitëse dhe qëndruan në vizitë përgatitore në selinë e ECDC në Stokholm. Për realizimin e vlerësimit, ekspertët e ECDC kanë vizituar institucionet kosovare të përfshira në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në nivel kombëtar dhe komunal. Draft raporti është shqyrtuar nga autoritetet e Kosovës për sëmundjet ngjitëse.

Standardet e vlerësimit janë fokusuar në kërkesat ekzistuese të Acquis të BE-së, standardet dhe udhëzimet e BE-së dhe ato ndërkombëtare si dhe praktikat e pranura përgjithësisht në shtetet anëtare të BE-së. Gjithashtu u vlerësuan elementet kritike të sistemit siç janë burimet njerëzore, të nevojshme që Kosova të marrë pjesë në mënyrë efektive në rrjetet evropiane të kontrollit të sëmundjeve ngjitëse, duke përfshirë Sistemin e Paralajmërimit dhe Reagimit të Hershëm dhe Komitetin e Sigurisë Shëndetësore.

Raporti referent është i ndarë në 6 kapituj që mbulojnë fushat e mëposhtme: *qeverisja shëndetësore* (kapitulli 1); *zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore* (kapitulli 2); *mbikëqyrja dhe kontrolli* (kapitulli 3); *gatishmëria, reagimi dhe menaxhimi i krizës* (kapitulli 4); *sistemi i mikrobiologjisë së shëndetit publik* (kapitulli 5); dhe *programet kombëtare të sëmundjeve* (kapitulli 6).

Bazuar në sfidat e identifikuar nga raporti sipas kapitujve përkatës, janë definuar edhe 6 objektiva specifike, arritja e së cilave synohet me realizim të aktiviteteve të përcaktuara në Planin e veprimit të këtij dokumenti që kanë për qëllim fillimin e zbatimit të rekomandimeve në fushën e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse.

Plani trevjeçar i veprimit (2022-2025) përmban aktivitetet e planifikuara prioritare dhe institucionet/akterët e nevojshëm për t'i zbatuar ato, afatin kohor për arritjen e veprimeve prioritare; buxhetin e kërkuar dhe organet që do të financojnë dhe/ose bashkëfinancojnë këto aktivitete. Plani i Veprimit do të jetë kyç në negociatat e anëtarësimit të Kosovës në BE për Kapitullin 28 (Shëndeti dhe Mbrojtja e Konsumatorit) dhe për këtë arsye zbatimi i tij do të monitorohet rregullisht.

Monitorimi i zbatimit të Planit do të bëhet nga mekanizmat e krijuar institucional në kuadër të MSh-së përmes monitorimit periodik të indikatorëve të përcaktuar. Raportet e monitorimit do të bëhen dy herë në vit.

## 2. HYRJA

Sëmundjet ngjitëse përbëjnë një kërcënim serioz për shëndetin publik dhe përcillen me ndikim të rëndësishëm mjekësor, ekonomik dhe social.

Synimet e sektorit të shëndetësisë në fushën e sëmundjeve ngjitëse janë krijimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve të nevojshme, të cilat do të mundësonin sigurimin e një sistemi mbikëqyrës funksional dhe efikas që ka për qëllim parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse në Republikën e Kosovës.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2025 në kuadër të objektivës strategjike ruajtja dhe përparimi i shëndetit, i jep prioritet parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse, përmes hartimit të Programit për sëmundje ngjitëse 2023-2032, në koordinim me Qendrën Evropiane për kontrollin e sëmundjeve (QEKS/ECDC). Po ashtu, në kuadër të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA) në kapitullin e 28 "Konsumatori dhe mbrojtja e shëndetit publik", shëndeti publik, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse është prioriteti kryesor.

Me Vendimin nr 10/24 të datës 14/08/2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Koncept dokumentin për sëmundje ngjitëse, i cili hap rrugën për hartimin e Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuara.

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit aktual do të mundësojë përgjigjen epidemiologjike adekuate, menaxhimin e drejtë të rasteve të sëmundjeve ngjitëse nga profesionistët shëndetësor, përfshirë këtu parandalimin, zvogëlimin e rrezikut të përhapjes së mëtejme dhe trajtimin adekuat të sëmundjeve ngjitëse.

Bazuar në vlerësimin e MSh, korniza ligjore e sëmundjeve ngjitëse nuk është e përafuar me legjislacionin e BE-së. Të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzimet dhe protokollat kanë nevojë të përafrohen me legjislacionin e BE-së, në mënyrë që të sigurohet një sistem mbikëqyrjeje i mirë, funksional dhe efikas në përputhje me këtë legjislacion. Legjislacioni aktual në Kosovë nuk ka përcaktuar qartazi disa role dhe përgjegjësi të institucioneve në praktikë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ndërhyrjen në rast të shpërthimeve të sëmundjeve që barten përmes ujit dhe ushqimit (p.sh. inspektorati sanitar dhe strukturat e inspektoratit shëndetësor) dhe ky aspekt duhet të adresohet në legjislacion.

Inicimi i hartimit të Programit për sëmundje ngjitëse, rrjedhë nga Raporti i vlerësimit teknik për Kosovë i realizuar nga QEKS/ECDC në vitin 2018, i cili përfshin qeverisjen e sektorit të shëndetësisë, vlerësimin e zhvillimit të kapaciteteve, mbikëqyrjen, gatishmërinë dhe reagimin në fushën e sëmundjeve ngjitëse, mikrobiologjinë e shëndetit publik dhe programet e sëmundjeve

të ndryshme. Ky raport përmban analizën e situatës, sfidat dhe rekomandimet për adresimin e mangësive të identifikuara.

Programi për sëmundje ngjitëse do të jetë një instrument me të cilin do të monitorohet procesi i negociatave të kapitullit 28 për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> *Kosovo\* Assessment of capacity development, health governance, surveillance, preparedness and response in the field of communicable diseases, ECDC, 2018*

### 3. METODOLOGJIA

Hartimi i Programit për sëmundje ngjitëse 2022-2032 është bazuar në nevojat e identifikuara për aspektin kryesor që prek shëndetin publik – mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse.

Gjatë procesit të hartimit të dokumentit janë bërë shqyrtime analitike dhe konceptuale të kornizës ligjore ekzistuese, vlerësimet e realizuara si dhe raportet e përgatitura nga të gjitha institucionet relevante të përfshira në aspekte të ndryshme në fushën e mbikëqyrjes dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse.

Janë analizuar edhe dokumente tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare, janë realizuar takime dhe konsultime me grupe të interesit, shoqata të pacientëve dhe akterë të tjerë të përfshirë në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse.

Struktura e dokumentit është hartuar duke u bazuar në UA 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit.

Materiali kryesor i shqyrtuar për hartimin e këtij dokumenti ka qenë raporti i vlerësimit të ECDC “Kosovo- Assessment of capacity development, health governance, surveillance, preparedness and response in the field of communicable diseases”, 2018’. Në mbarëshkrimin e dokumentit është shfrytëzuar edhe korniza ligjore në vijim: Ligji nr. 04/125 për Shëndetësi, Ligji nr. 02/1-78 për Shëndet publik, Ligji nr. 02/1-109 për Parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligji nr. 2/L-38 për Inspektoratin shëndetësor, Ligji nr. 22/2003 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, Udhëzimi administrativ (UA) nr. 11/2013 për sistemin informativ shëndetësor dhe raportimin e të dhënave statistikore shëndetësore, UA 06/2015 Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, UA 02/2011 Veprimtaria, struktura dhe funksionet e shërbimeve shëndetësore për HIV/AIDS, UA 05/2010 për Vaksinoprofilaksë, seroprofilaksë dhe Kimio profilaksë, UA 05/2011 për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021 si dhe Plani strategjik nacional i veprimit për HIV/AIDS 2018-2022.

Dokumenti është hartuar nga grupi punues me përfaqësues nga MSh, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK), Inspektorati shëndetësor (ISh), profesionistë shëndetësorë të kyçur në mbikëqyrje dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse si dhe këshilltarë dhe ekspertë vendor dhe ndërkombëtar të cilët kanë përkrahur procesin e hartimit të dokumentit.

Hartimi i dokumentit është punuar sipas fazave të poshtëshënuara:

- Grumbullimi i të dhënave, shqyrtimi dhe analiza e dokumenteve relevante ekzistuese,
- Definimi i metodologjisë së punës së grupit, ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për anëtarë të grupit,

- Takimet e përbashkëta të punës dhe arritja e konsensusit për përfshirje të përmbajtjes në dokument,
- Hartimi i planit të veprimit përmes definimit të aktiviteteve për periudhë tri vjeçare 2022-2025;
- Konsultime ndërministrORE dhe publike gjatë gjithë procesit të hartimit të dokumentit.

Pas analizës së të dhënave në dispozicion janë nxjerrë përfundimet në bazë të së cilave janë identifikuar objektivat prioritare që përcaktojnë orientimin e zhvillimeve për mbikëqyrje dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse në Republikën e Kosovës.

Dokumenti përmban Planin e veprimit për periudhë tri vjeçare 2022-2025 me mundësi të përditësimit në baza vjetore.

## 4. SFONDI

### 4.1. QEVERISJA E SEKTORIT TË SHËNDETËSISË

Në kontekstin e shpërthimeve të sëmundjeve ngjitëse me rëndësi globale, qeverisja përfshin një sërë mekanizmash të integruar të politikave, menaxhimit të informacionit, komandës dhe kontrollit për të lehtësuar veprimet kolektive me qëllim të arritjes së objektivave për parandalim, zbulim dhe reagim. Kosova e njëj rëndësinë e mbrojtjes nga sëmundjet ngjitëse, duke e rregulluar këtë fushë me legjislacion gjithëpërfshirës. Stafi i motivuar në të gjitha nivelet është një aset kyç për përmirësimin e sistemit kombëtar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse. Janë krijuar institucionet përgjegjëse, me role dhe përgjegjësi të përcaktuara në fushën e sëmundjeve ngjitëse.

Bazuar në vlerësimin teknik të ECDC<sup>2</sup>, sfidat e identifikuara në fushën e qeverisjes janë:

- Korniza ligjore ende nuk është zbatuar plotësisht, veçanërisht në lidhje me ligjin mbi sëmundjet ngjitëse.
- Sektori privat nuk merr pjesë mjaftueshëm në sistemin kombëtar të mbikëqyrjes dhe kjo e zvogëlon ndjeshmërinë e sistemit.
- Mbrojtja e të dhënave nuk praktikohet në terren dhe të dhënat personale nuk ruhen siç duhet.
- Definicionet e rasteve të BE-së nuk zbatohen për të gjitha sëmundjet prioritare.
- Disa role dhe përgjegjësi të institucioneve mbivendosen në praktikë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ndërhyrjen në rast të shpërthimeve të sëmundjeve që barten përmes ujit dhe ushqimit (p.sh. inspektorati sanitar dhe strukturat e inspektoratit shëndetësor).
- Ka mungesë të bashkëpunimit formal mes sektorëve dhe institucioneve me përgjegjësi në parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse (Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, emergjenca civile).
- Roli i qendrave rajonale të IKShPK-së në mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse dhe hetimin e shpërthimit të epidemive është i dobët
- Modeli i financimit nuk është i qëndrueshëm pasi që bazohet në një buxhet historik
- Përdorimi i burimeve nuk është planifikuar në bazë të nevojave reale.

---

<sup>2</sup> Kosovo\* Assessment of capacity development, health governance, surveillance, preparedness and response in the field of communicable diseases, 2018

MSh, me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuar sa i përket sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse, ka planifikuar aktivitete dhe përcaktuar indikatorët për monitorim të zbatimit të aktiviteteve në Planin e veprimit të këtij dokumenti.

#### 4.2. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE

Raporti i ECDC në fushën e burimeve njerëzore, ka analizuar katër shtylla kryesore: planifikimin e fuqisë punëtore; fuqi punëtore e specializuar në lidhje me parandalimin e sëmundjeve ngjitëse; financimi i programeve të arsimit dhe trajnimit dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe rilicencimi.

Raporti teknik ka identifikuar shtatë dobësi dhe më pas janë dhënë rekomandimet e duhura nga ECDC. Nga rekomandimet kanë dalë objektivat dhe aktivitetet strategjike që do të zbatohen dhe realizohen gjatë tre viteve të para (2022-2024):

- Zhvillimi i Planit dhjetëvjeçar të burimeve njerëzore – janë planifikuar aktivitetet e mëposhtme: krijimi i grupit të punës për të analizuar ngarkesën e BNj, zhvillimi i planit afatgjatë të zbatimit për të përmirësuar mbulimin dhe përditësimi i bazës së të dhënave të BNj.
- Rishikimi i funksioneve të shëndetit publik që do të kryhen në nivel rajonal dhe kombëtar, përshtatja e postit dhe përshkrimit të punës me këto funksione: përditësimi dhe monitorimi i kritereve të normave dhe standardeve për burimet njerëzore, Procedurat Standarde të Operacionit (PSV) të rishikuara.
- Rishikimi i programeve të trajnimit pasuniversitar në Shëndetin Publik dhe Epidemiologjinë: përfshin përditësimin e kurrikulës së specializimit të Shëndetit Publik/Epidemiologjisë dhe hartimin e programit për të gjithë zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP).
- Ngritja e kapaciteteve për specialistët e shëndetit publik/epidemiologjisë dhe specialistët e mjekësisë familjare, në aplikimin e trajnimeve bazë në menaxhimin e të dhënave dhe softuerin e analizës, përfshin trajnimin në përdorimin dhe analizën e të dhënave bazuar në nevojat dhe TR për trajnimin e analizës së mbikëqyrjes.
- Integrimi i mjekëve të mjekësisë familjare në ekipet e reagimit të komunitetit të udhëhequra nga institutet rajonale të shëndetit publik, përfshin aktivitete si zhvillimi i planit të veprimit të reagimit të komunitetit, krijimi i ekipit të kombinuar të reagimit të komunitetit dhe trajnimi i ekipeve të kombinuara të reagimit të komunitetit.

- Forcimi i komunikimit ndërmjet shëndetit publik dhe mjekëve të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, përfshin shpërndarjen e raporteve të shëndetit publik për publikun dhe organizimin e tryezave të rrumbullakëta me palët e interesuara për të diskutuar gjetjet.

- Identifikimi dhe prioritizimi i kërkimit shkencor të shëndetit publik për t'u përfshirë në planet kombëtare të kërkimit. Kjo pikë përfshin zhvillimin e planit të shpejtë kombëtar të kërkimit dhe identifikimin e fushave prioritare në fushën e kërkimit të shëndetit publik.

Zbatimi i aktiviteteve është planifikuar të financohet më së shumti nga buxheti i shtetit, MSh, Kujdesi Parësor Shëndetësor, akterët ndërkombëtarë, partnerët dhe donatorët, përfshirë Bankën Botërore. Institucionet udhëheqëse janë IKShPK, MSh, Kujdesi Parësor Shëndetësor dhe Odat e profesionistëve shëndetësorë, ndërsa institucionet mbështetëse, ndër aktorët ndërkombëtarë, partnerët dhe donatorët, janë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Prioritetet e përmbledhura të analizës SWOT lidhur me planifikimin e burimeve njerëzore janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

| Përparësitë  | Mangësitë   |
|--|---|
| <p>Struktura demografike e favorshme (popullsia e re)</p> <p>Forcimi i rolit të Odave të Profesionistëve Shëndetësor dhe shoqatave profesionale</p> <p>Vlerësimi i situatës aktuale të BNJ</p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e Planit dhjetëvjeçar të BNJ</li> <li>• Rishikimi i funksioneve të shëndetit publik, në nivel rajonal dhe kombëtar, përshkrimit të detyrave të punës, Procedurat Standarde të Operacionit (PSV)</li> <li>• Rishikimi i programeve të trajnimit pasuniversitar në Shëndetin Publik dhe Epidemiologjinë</li> <li>• Perditësimi i programit për zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZHVP)</li> <li>• Mungesa e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për specialistët e shëndetit publik/epidemiologjisë dhe specialistët e mjekësisë familjare</li> <li>• Mungesa e integritit të qëndrueshëm të mjekëve të mjekësisë familjare në ekipet e reagimit të komunitetit të udhëhequra nga institutet rajonale të shëndetit publik</li> <li>• Mungesa e planit të veprimit të reagimit të komunitetit dhe trajnimeve të ekipeve të kombinuara të reagimit të komunitetit</li> <li>• Komunikim i dobët ndërmjet Shëndetit Publik dhe mjekëve të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare, sidomos sa i përket shpërndarjes së raporteve të shëndetit publik për publikun dhe organizimin e</li> </ul> |

|   |  |
|---|--|
|   | <p>tryezave të rrumbullakëta me palët e interesuara për të diskutuar gjetjet</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë e identifikimit dhe prioritizimit të kërkimit të shëndetit publik për t'u përfshirë në planet kombëtare të kërkimit</li> <li>• Mungesa e bazës së të dhënave të burimeve njerëzore</li> <li>• Mungesa e mekanizmit të detajuar të monitorimit dhe vlerësimit për të përmirësuar performancën e BNj</li> </ul>  |
| <p><b>Mundësitë</b></p>   | <p><b>Kërcënimet</b></p>   |
| <p>Konsultimi me palët e interesuara për të vlerësuar nevojat për burime njerëzore</p> <p>Planifikimi i BNj si pjesë e planifikimit kombëtar të shëndetit</p> <p>Planifikimi dhe rekrutimi i BNj nga çdo institucion shëndetësor</p> <p>Hartimi dhe përditësimi i programeve të specializuara dhe puna me Komitetet Specialistike</p> <p>Krijimi i një mekanizmi të qartë të mbikqyrjes dhe Vlerësimit në sistemin shëndetësor</p> <p>Krijimi i një baze të qëndrueshme të të dhënave të burimeve njerëzore</p> <p>Mekanizmi ZhVP i rregulluar në Kosovë</p> <p>Shfrytëzimi i kapaciteteve të Telemjekësisë në Kosovë për mbështetjen e BNj për konsultime si dhe për përcjelljen e trajnimeve në distancë.</p> | <p>Mbiprodhimi ose mungesa, papunësia, migrimi i stafit</p> <p>Vlerësimi i aftësive të BNj bazuar në nevojat dhe forcimi i mekanizmave të ZhVP për të rritur cilësinë e kujdesit dhe shërbimeve të ofruara.</p> <p>Bërja e sektorit shëndetësor më tërheqës për të diplomuarit</p> <p>Mungesa e krijimit të stimujve financiarë për të punuar në zonat rurale dhe të largëta për ekipet e kujdesit parësor, me koeficientë të rritur.</p> <p>Mungesa e pagesës në bazë të performancës</p> <p>Rolet e papërcaktuara të punonjësve shëndetësorë (kualifikimet) për të parandaluar migrimin e BNj</p> <p>Delegimi i detyrave</p> |

Republika e Kosovës, si shteti më i ri në Evropë, ka popullsinë më të re dhe për rrjedhojë relativisht të shëndoshë, një rrjet të mirë të shpërndarë të institucioneve shëndetësore dhe staf profesional të përkushtuar që ofron kujdes parësor shëndetësor të krahasueshëm me vendet e rajonit. Profili demografik dhe përpjekjet e mëdha të institucioneve dhe profesionistëve të tyre shëndetësorë, përkundër financimit të ulët të shëndetësisë kosovare nga burimet publike financiare, sjellin gjendje të mirë të përgjithshme shëndetësore të popullatës.

Mënyrat e jetesës së shëndetshme, konsumimi i kënaqshëm i frutave, aktiviteti i mirë fizik dhe faktorët e ulët të rrezikut që lidhen me përdorimin e alkoolit, faktorët e rrezikut për HIV/AIDS dhe tuberkulozin si dhe shkallët e larta të imunizimit, rezultojnë në gjendje më të mirë shëndetësore të popullatës në përgjithësi. Pavarësisht sfidave ekzistuese në sektorin e shëndetësisë, popullata mbetet e kënaqur me shërbimet e ofruara nga rrjeti ekzistues i institucioneve shëndetësore publike dhe private, me kapacitet të mjaftueshëm për të ofruar shërbime për popullatën, edhe pse kërkesat për shërbime janë në rritje.<sup>3</sup>

Burimet njerëzore përbëjnë burimin më të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve shëndetësore publike. Si në shumë vende të tjera, Kosova përballlet me sfidën e inkurajimit të profesionistëve shëndetësorë që të punojnë në më shumë zona rurale, duke përfshirë punën me komunitetet e varfëra dhe më të cenueshme, në mënyrë që të plotësohen nevojat e popullsisë. Investimi dhe zhvillimi i fuqisë punëtore të shëndetit publik është një parakusht thelbësor për ofrimin dhe zbatimin adekuat të shërbimeve dhe aktiviteteve të shëndetit publik (Raporti i ShESHP/EPHO, IKSHPK 2020). Një sfidë e rëndësishme është se si të forcohet komunikimi ndërmjet shëndetit publik dhe mjekëve të qendrave kryesore të mjekësisë familjare. Një opsion mund të jetë planifikimi i takimeve ndër-profesionale dhe tryezave të rrumbullakëta të theksuara gjatë shpërndarjes së raporteve të shëndetit publik. Këto takime mund të përmirësojnë rolin e mjekëve dhe ekipeve të mjekësisë familjare në reagimin e komunitetit, të udhëhequr nga institutet rajonale të shëndetit publik. Në të ardhmen e afërt ekziston nevoja për të zhvilluar një plan veprimi për reagimin e komunitetit dhe në bazë të tij përgatitja dhe kryerja e trajnimeve për ekipet e kombinuara të reagimit të komunitetit.

Planifikimi i burimeve njerëzore, mjedisit klinik dhe pajisjeve në sistemin shëndetësor është i standardizuar dhe rregulluar me ligje, udhëzime/akte ligjore dhe nënligjore të miratuara nga MSH që nga viti 2000 (Aneksi 2). Profilet e profesionistëve shëndetësorë dhe arsimit specialistik rregullohen me akte ligjore dhe nënligjore të MSh-së. Divizioni i burimeve njerëzore të MSh-së, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë të përcaktuara në nenin 33 të Rregullores (GRK) Nr. 07/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të MSH-së, ka përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin e BNj. Kjo aktualisht ndërmerret vetëm në baza ad-hoc bazuar në kërkesat e institucioneve shëndetësore për rekrutimin e personelit, e jo përmes një procesi të planifikuar dhe të rregulluar. Planifikimi i arsimit të specializuar ndërmerret në bazë

---

<sup>3</sup> Health Sector Strategy 2017-2021

të UA nr. 05/2017, neni 9. Është planifikuar një veprim konkret për rishikimin e funksioneve të shëndetit publik që kryhen në nivel rajonal dhe kombëtar, përshtatjen e postit dhe përshkrimit të punës me këto funksione dhe qartësimin/rishikimin e standardeve të funksionimit. Procedurat (PSV).

Burimet njerëzore në sektorin e shëndetësisë financohen nga Buxheti i Kosovës. Financimi për personelin që punon në kujdesin dytësor dhe tretësor shpërndahet përmes MSH-së, financimi për personelin që punon në kujdesin parësor përfshihet në Grantin Special për Shëndetësi të dhënë nga Ministria e Financave për Komunitet. Shuma e grantit është përcaktuar në përputhje me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe pagat përbëjnë rreth 65% të buxhetit të përgjithshëm.

Burimet njerëzore për shëndetin nuk mund të zhvillohen me sukses pa inputet që duhet të ofrohen nga një sërë institucioneve jashtë MSH-së, prandaj një sërë palësh të interesuara janë të përfshirë në formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për BNJ duke përfshirë Ministrinë e Financave, MASHT-in, Institucionet Shëndetësore, Institucionet e Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, Bordi për Edukim Specialist, Bordi për CPE, OJQ-të, Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës, Shoqatat për të Drejtat e Pacientëve.

Akreditimi i institucioneve arsimore dhe programeve të studimit në Kosovë organizohet nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC). Është një autoritet i pavarur, i cili akrediton dhe riakrediton institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat për një periudhë të kufizuar kohore. Dihet se Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZhVP) për profesionistët shëndetësorë rezulton në përmirësimin e performancës së BNJ. Përmirësimi i rekrutimit dhe mbajtjes së stafit është një çështje kritike për t'u trajtuar në vitet e ardhshme dhe është identifikuar si një fushë prioritare.

Përmirësimi i shëndetit të popullatës varet nga cilësia dhe gatishmëria e fuqisë punëtore të shëndetit publik, dhe kjo varet nga edukimi dhe trajnimi i saj. Prandaj investimi në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të fuqisë punëtore të shëndetit publik është faktor bazë për ofrimin dhe zbatimin e Shërbimeve Shëndetësore Publike.

Fuqia punëtore përbën burimin më të rëndësishëm në ofrimin e Shërbimeve të Shëndetit Publik. Me Ligjin Nr. 04/L-150 për Odat Profesionale Shëndetësore, u formuan këto oda profesionale: Oda e Mjekëve të Kosovës, Oda Stomatologjike e Kosovës, Oda e Farmacistëve, Oda e Fizioterapistëve të Kosovës dhe Oda e Infermierëve, Mamive dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë. Këto oda të sapoformuara të profesionistëve të shëndetësisë në Kosovë janë organizata të pavarura që mbrojnë dhe prezantojnë interesat profesionale të anëtarëve të saj, ofrojnë standarde të larta të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovojnë dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, ofrojnë edukime profesionale të vazhdueshme. MSH së bashku me Odat Mjekësore, Bordin për Specializim, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Katedrat nga Shëndetësia Publike, Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës janë organe të përshtatshme për të filluar një proces të rishikimit të programeve të trajnimit të kurrikulës së specializimit pasuniversitar në

Shëndetin Publik/Epidemiologji si dhe hartimin e programit të aktiviteteve për ZhVP për të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor, i cili mund të sigurojë trajnime të duhura dhe të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve për specialistët e shëndetit publik/epidemiologjisë dhe specialistët e mjekësisë familjare, në aplikimin e trajnimeve bazë në softuerin e menaxhimit dhe analizës së të dhënave.

Krahasuar me rajonin evropian, Kosova ka numër të pamjaftueshëm të mjekëve dhe infermierëve. Numri i mjekëve për 100,000 banorë në Kosovë është më i ulëti në rajon (rreth 111 mjekë, ndërsa në vitin 2009 në BE 320, Shqipëri 115, Maqedoni 255, Mali i Zi 199, Serbi 204). Në vendin tonë si dhe në vendet e tjera të rajonit dhe jashtë BE-së fokusi është fuqizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor, decentralizimi i shërbimeve në nivel lokal, legalizimi i sektorit privat. Vlen të theksohet se Ligji për Sigurimin Shëndetësor ende nuk është zbatuar në Kosovë (SEEHN). Me qëllim të analizimit të ngarkesës së punës së BNj krijimi i GP është një nga aktivitetet. Përveç kësaj, nevojitet zhvillimi i planit afatgjatë të zbatimit të BNj për të përmirësuar mbulimin, bazuar në gjetjet nga vlerësimi i BNj. Kjo do të rezultojë me përditësimin e bazës së të dhënave të burimeve njerëzore.

Avancimi i kërkimit të shëndetit publik është parë shumë i rëndësishëm, veçanërisht identifikimi i kërkimeve prioritare në fushën e shëndetit publik për të informuar politikat dhe praktikën dhe për të mundësuar vendimmarrje. Një veprim prioritar është zhvillimi i planit të shpejtë kombëtar të kërkimit për shëndetin publik si dhe rritja e kapaciteteve në zhvillimin e propozimeve kërkimore për kërkimin e programeve financuese të BE-së dhe komunitetit ndërkombëtar të donatorëve (EPHO Raporti IKSHPK 2020).

### 3. MBIKËQYRJA DHE KONTROLI

Raporti teknik i ECDC-së ka analizuar pesë çështje kryesore lidhur me Mbikëqyrjen dhe Kontrollin respektivisht: përshkrimi i sistemit; monitorimi dhe vlerësimi i sistemit; koordinimi dhe integrimi i sistemit; menaxhimi rutinë i sëmundjeve ngjitëse të raportueshme; përgjigje në nivel kombëtar ndaj epidemive të sëmundjeve ngjitëse me rrezikshmëri të lartë.

Raporti teknik ka identifikuar pesë pikë të dobëta dhe më pas janë dhënë rekomandimet e duhura nga ECDC. Nga rekomandimet janë hartuar objektivat dhe aktivitetet strategjike që do të zbatohen dhe realizohen gjatë tre viteve të para, d.m.th.: 2022-2024. Për të përmbushur rekomandimet e ECDC, planifikohet të ndërmerren këto aktivitete:

- **Realizimi i një vlerësimi të sistemit të mbikëqyrjes** - Për përmbushjen e rekomandimit janë planifikuar këto aktivitete: 1) Vlerësimi i sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse, aktivitet i cili është planifikuar të realizohet në tremujorin e dytë të vitit 2022. Produkt përfundimtar i këtij aktiviteti do të jetë hartimi i Raportit të Vlerësimit të sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse. 2) Formimi i një grupi punues për përcaktimin e

nevojave të sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse, aktivitet i cili do të udhëhiqet nga MSH dhe IKSHPK. 3) Vizita studimore për sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në ECDC ose në ndonjë vend të rajonit (si model), vizitë e cila do të ndihmojë në shkëmbimin e përvojave profesionale, e cila është planifikuar të realizohet në tremujorin e tretë të vitit 2022. 4) Dizajnimi i sistemit të integruar digjital për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse, i cili synon krijimin e një sistemi funksional dhe të digjitalizuar për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse. 5) Faza e pilotimit të sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse, 6) Funkcionalizimi dhe aplikimi i sistemit.

- **Definimi i qartë i objektivave dhe prioriteteve të sistemit të mbikëqyrjes** – Përcaktimi dhe definimi i objektivave dhe prioriteteve të sistemit të mbikëqyrjes është planifikuar të realizohet në vitin 2022.
- **Vendosja e prioriteteve dhe përshtatja e listës së sëmundjeve të raportueshme me nevojat aktuale, duke përfshirë inkuadrimin e specialistëve të sëmundjeve ngjitëse dhe inkuadrimin e laboratorëve** – Gjatë vitit 2022 është planifikuar të bëhet krijimi i komisionit për përditësimin e listës së sëmundjeve ngjitëse sipas BE-së për raportim dhe përshtatja e listës konform territorit të Kosovës. Produkt final i këtij aktiviteti është miratimi i Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse.
- **Hartimi i definimeve praktike të rastit në nivel kombëtar në përputhje me përkufizimet e rastit të BE-së, duke përfshirë definimet klinike (suspekte) dhe të konfirmuara** – Përpilimi i definimit të rastit për sëmundjet ngjitëse sipas listës së sëmundjeve ngjitëse, EC (ECDC) të përshtatur për Kosovën.
- **Përcaktimi i metodologjisë dhe zbatimi i monitorimit të plotshmërisë dhe vlefshmërisë së brendshme** - Hartimi i metodologjisë së Procedurave Standarde të Operimit (PSO) lidhur me monitorimin e plotshmërisë dhe vlefshmërisë së të dhënave është planifikuar të realizohet gjatë viteve 2022-2023.
- **Sistematizimi dhe zyrtarizimi i aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe përgjegjes në udhërrëfyesit dhe PSO-të e përditësuara p.sh. për mbikëqyrjen (duke përfshirë mbikëqyrjen e bazuar në indikator dhe ngjarje), vlerësimin e rrezikut dhe për hulumtimin e epidemisë** - 1) Hartimi dhe përditësimi i udhërrëfyesve për sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse është planifikuar të realizohet gjatë viteve 2022-2023, 2) trajnimi i profesionistëve shëndetësorë lidhur me sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse është planifikuar të realizohet gjatë viteve 2022-2023.
- **Rishikimi i përmbajtjes (duke përfshirë prezantimin e të dhënave) së buletineve mujore dhe vjetore në nivel rajonal dhe kombëtar** – 1) Ridizajnimi i buletineve mujore dhe vjetore sipas modeleve të ECDC, 1) trajnimi i epidemiologëve për analizën e të dhënave është planifikuar në tremujorin e tretë të vitit 2022.

- **Implementimi i një sistemi të shërbimit 24/7 për epidemiologët, me telefona dhe numra të dedikuar, për të siguruar disponueshmërinë e personelit në nivel kombëtar dhe rajonal për t'iu përgjigjur shpejt dhe me efikasitet ngjarjeve të shëndetit publik - 1) Zbatimi i sistemit 24/7 për gatishmërinë epidemiologjike dhe përgjegje të shpejtë, 2) Sigurimi i sistemit telefonik për kujdestarinë në thirrje.**
- **Realizimi i një takim/telekonferencë të rregullt (në nivel kombëtar dhe rajonal) për diskutimin dhe vlerësimin e ngjarjeve të identifikuara përmes inteligjencës epidemike - Trajnimi/ritrajnimi i epidemiologëve.**
- **Në të ardhmen e afërt, të bashkohen bazat e të dhënave ekzistuese nga Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike për të formuar një bazë të dhënash kombëtare (të mos parashikohet që SISH i ri do të plotësojë nevojat e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse/paralajmërimit të hershëm) - Unifikimi i bazës së të dhënave në Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike dhe IKSHPK-ës.**
- **Rekomandimet laboratorike që kërkohen për të mbështetur mbikëqyrjen - Shumica e rasteve të raportuara bazohen në vlerësimin klinik pa konfirmim laboratorik. Hulumtimi i epidemive është i kufizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve laboratorike.**
- **Rekomandime për aktivitetet e trajnimit - Nuk ka plan për të siguruar një grup epidemiologësh të trajnuar mirë në nivel qendror dhe rajonal për të mbështetur aktivitetet e ardhshme të mbikëqyrjes dhe përgjegjës epidemiologjike.**

Realizimi i aktiviteteve është planifikuar të financohet kryesisht nga buxheti i shtetit, Ministria e Shëndetësisë, Kujdesi Parësor Shëndetësor, akterët ndërkombëtarë, partnerët dhe donatorët, përfshirë Bankën Botërore, RKI. Institucionet udhëheqëse janë IKSHPK, MSH, Komisioni për hartimin e listës së sëmundjeve ngjitëse dhe institucionet mbështetëse siç janë palët e interesuara, partnerë dhe donatorë ndërkombëtarë dhe PTK.

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Përparësitë:</b></p> <p>Në vitin 2019 në bashkëpunim me Institutin Robert Koch të Berlinit, është hartuar Udhëzuesi për Hulumtimin e Epidemisë dhe Përgjigjen Epidemiologjike.</p> | <p><b>Mangësitë:</b></p> <p>Dizajnimi i sistemit të mbikëqyrjes, duke përfshirë prioritizimin e sëmundjeve, u bazua në nevojat e pasluftës dhe kërkon rivlerësim.</p> <p><input type="checkbox"/> Janë bërë shkresa dhe përmbledhje të panevojshme të dhënash, të cilat nuk sjellin informacion për veprim.</p> <p><input type="checkbox"/> Një pjesë e madhe e raportimit është vetëm në formë të përmbledhur (për</p> |
|--|---|

|  |   |
|--|---|
|  | <p>pesë sëmundjet/sindromat me numrin më të madh të raporteve të rasteve).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Ka nën-raportim për disa sëmundje, veçanërisht IST.</li> <li><input type="checkbox"/> Ka nën-raportim nga sektori privat dhe nga popullata serbe.</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk është ndërmarrë asnjë monitorim i plotshmërisë dhe vlefshmërisë së brendshme.</li> <li><input type="checkbox"/> Shumë aktivitete të mbikëqyrjes dhe përgjigjes janë ad-hoc dhe nuk bazohen në udhëzime/PSO.</li> <li><input type="checkbox"/> Udhëzuesit ekzistues të mbikëqyrjes/PSO-të janë të vjetruara.</li> <li><input type="checkbox"/> Analiza e të dhënave të disponueshme është vetëm analizë përshkruese, është shumë e kufizuar në nivel rajonal dhe kombëtar dhe nuk shpie në veprime të shëndetit publik.</li> <li><input type="checkbox"/> Rrjedha dhe koordinimi ndërsektorial i informacionit duhet të fuqizohet dhe formalizohet për detektimin dhe përgjigjen.</li> </ul> <p>Nuk ka rrjet kombëtar të kompjuterizuar elektronik për mbikëqyrjen e sëmundjeve ngjitëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Sistemi Informativ Shëndetësor i parashikuar nuk është funksional dhe mund të mos funksionojë për disa kohë.</li> <li><input type="checkbox"/> Shumica e rasteve të raportuara bazohen në vlerësimin klinik pa konfirmim laboratorik.</li> <li><input type="checkbox"/> Hulumtimi i epidemisë është i kufizuar për shkak të mungesës së kapaciteteve laboratorike.</li> <li><input type="checkbox"/> Nuk ekziston asnjë plan për të siguruar një grup epidemiologësh të trajnuar mirë në nivel qendror dhe rajonal për të mbështetur aktivitetet e ardhshme të mbikëqyrjes dhe përgjigjes.</li> </ul> |
|--|---|

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Mundësitë:</b></p> <p>Ministria e Shëndetësisë është e angazhuar dhe ka formuar një grup pune për zhvillimin e digjitalizimit të sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse;</p> | <p><b>Kërcënimet:</b></p> <p>Realizimi i telekonferencave për takime të rregullta të epidemiologëve mund të pengohet nga mungesa e buxhetit;</p> <p><input type="checkbox"/> Numri i vogël i profesionistëve shëndetësorë, epidemiologë/profesionistë të shëndetit publik në Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik për shkak të ngarkesës së punës, mund të ndikojë në cilësinë dhe efektivitetin e punës;</p> <p><input type="checkbox"/> Mundësia e mosmiratimit të Ligjit për sëmundjet ngjitëse.</p> |
|--|---|

Përkundër zhvillimeve dhe zbulimeve të mëdha në mjekësinë bashkëkohore, shtetet në mbarë botën në vazhdimësi janë duke u ballafaquar me kërcënimet nga sëmundjet ngjitëse, qoftë si pasojë e paraqitjes natyrale të tyre, aksidentale apo të qëllimtë. Viteve të fundit paraqitja e epidemive të sëmundjeve ngjitëse me tendencë të përhapjes në formë pandemike si: Ebola, Lassa, Zika, MERS-CoV, COVID-19, murtaja, kolera dhe gripi janë indikatorë të kërcënimeve globale me agjensë biologjik. Njëkohësisht, paraqitja e sëmundjeve ngjitëse dhe rishfaqja e atyre të cilat për një kohë të gjatë mbaheshin nën kontroll janë sinjal i kapaciteteve të pamjaftueshme të shteteve për të parandaluar, zbuluar, vlerësuar rrezikun dhe ndërmarrjen e masave parandaluese dhe kontrolluese. Paraqitja e epidemive në shkallë më të gjerë kërcënon shëndetin dhe sigurinë publike e cila përcillet me pasoja ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Epidemitë e sëmundjeve ngjitëse definojnë si sfida multisektoriale si psh. epidemitë e sëmundjeve të kafshëve janë kërcënim i sigurisë së ushqimit të cilat kanë reperkusion negativ në ekonominë vendore dhe paraprinë epidemive ndër njerëz. Pandemitë dhe epidemitë e mëdha kanë impakt negativ afatgjatë si në ekonominë vendore ashtu edhe atë ndërkombëtare. Qasja multisektoriale mundëson përforcimin e kapaciteteve nacionale për të parandaluar dhe ofruar përgjegjen epidemike adekuate.

Sëmundjet ngjitëse, të cilat duhet të mbulohen nga rrjeti i mbikëqyrjes epidemiologjike, përzgjidhen sipas kriterëve bazë të mëposhtme:

- të jenë sëmundje që shkaktojnë apo kanë mundësi të shkaktojnë sëmundshmëri dhe/ose vdekshmëri të lartë në vend dhe rreth tij dhe për të cilat duhet të ketë një koordinim kombëtar, ndërkufitar e global;

- të jenë sëmundje, për të cilat shkëmbimi i informacionit siguron njoftim të hershëm të kërcënimeve për shëndetin publik;
- të jenë sëmundje të rralla dhe serioze, që nuk dallohen menjëherë, në nivel kombëtar, por për të cilat grumbullimi i informacionit lejon zhvillimin e hipotezave dhe zbulimin e shpërthimeve epidemike;
- të jenë sëmundje për të cilat ekzistojnë masa parandalimi efektive, që sjellin përfitime në mbrojtjen e shëndetit;
- të jenë sëmundje, ngjarja e të cilave, kur krahasohet me ngjarjen në vende të tjera, mund të kontribuojë në vlerësimin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

## **Shëndeti publik dhe sëmundjet ngjitëse**

### **Analiza e situatës epidemiologjike<sup>4</sup>**

Më shumë se gjysma e sëmundjeve ngjitëse të raportuara në Kosovë, në periudhën pesëvjeçare kanë të bëjnë me sëmundjet me origjinë respiratore, mjedisore, ushqimore, ujore ose zoonotike; pasuar nga sëmundjet vaksinëpreventabile. Rëndësi e veçantë për këto sëmundje është rreziku i përhapjes së shpejtë dhe shfaqja në formë të epidemive, me mundësi të përhapjes ndërkufitare.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve me sëmundje ngjitëse të raportuara në Kosovë, 47.24% janë infeksionet respiratore – ILI (sëmundje e ngjashme me gripin) 3 875.21 raste/100.000 banorë, ARI (infeksione akute respiratore) 3 38.6 raste/100.000 banorë, pasuar nga sëmundjet gastrointestinale të raportuara si diarre akute dhe sëmundje që barten me ushqim. Kryesisht janë raportuar në formë të epidemive qoftë familjare apo kolektive dhe poashtu si raste sporadike. Viti 2017 dhe 2019 kanë shënuar numrin më të madh të rasteve me 91 312, respektivisht 87 635 raste.

### **Sëmundjet e traktit respirator**

Nga viti 2016-2020 janë raportuar gjithsej 362 605 raste me sëmundje e ngjashme me gripin (ILI). Numri më i madh i rasteve është raportuar në vitin 2019 me 79 952 ose Mb 4 375.58/100 000 banorë, ndërsa numri më i vogël i rasteve është raportuar në vitin 2017 me 51 504 ose Mb 2 818.7/100 000 banorë. Analizuar sipas sipas grup-moshës, vërehet një tendencë e rritjes të grup moshë 0-4 dhe mbi 65 vjeç pa dallim gjinie. Nga viti 2016-2020 janë raportuar gjithsej 58 583 raste me Infeksion akut respirator (ARI). Numri më i madh i rasteve është raportuar në vitin 2016 me 13 897 ose Mb 760.5/100 000 banorë, ndërsa numri më i vogël i rasteve është raportuar në vitin 2020 me 6 187 ose Mb 338.6/100 000 banorë. Analizuar sipas grup-moshës, më e atakuar është grup-moshë prej 5- 49 vjeç me gjithsej 21 748 raste pa dallim gjinie.

---

<sup>4</sup> Analiza e situatës epidemiologjike në Kosovë 2016-2020, IKShPK

## **Sëmundjet vaksinëpreventabile**

Sëmundjet vaksinëpreventabile, po ashtu regjistrohen çdo vit në Kosovë, edhe përkundër mbulesës së lartë me vaksinim. Sikurse edhe në mbarë botën, sidomos rajoni dhe Evropa edhe Kosova është ballafaquar dy vitet e fundit me paraqitjen e rasteve të fruthit. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë raporton për rritje të shkallës së sëmundshmërisë nga fruthi në Rajonin e Evropës për 400 herë më të lartë krahasuar me vitet e kaluara. Kosova në vitin 2017 karakterizohet me paraqitjen e rasteve të fruthit që mori karakter epidemik me 538 raste. Përkeqësimi i situatës erdhi si pasojë e lëvizjeve të një pjese të komunitetit RAE nëpër shtetet e rajonit. Kontrolla e sëmundjeve vaksinëpreventabile kërkon mbështetje ligjore përmes fuqizimit të sistemit efikas të mbikëqyrjes. Përgjatë periudhës 10 vjeçare janë paraqitur 7109 raste me Sëmundje Vaksinë Preventabile nga të cilat 6107 Parotit epidemi, 117 Pertusis, 154 Rubellë, 3 raste me Tetanos si dhe 728 raste Morbill. Lëvizja e rasteve të sëmundjes ndër grupmosha i përgjigjet rrjedhës natyrale të fruthit, ku numri më i madh i rasteve i takon fëmijëve nën 6 vjeç 54.2%. Në periudhën kohore 1 mars 2017– 31 dhjetor 2018, gjinia më e prekur nga fruthi është gjinia mashkullore. Nga 728 raste, 353 i takojnë gjinisë femërore dhe 375 të gjinisë mashkullore, andaj nuk ka dallim të theksuar. Analiza e rasteve të sëmundjeve në përgjithësi dhe të fruthit në veçanti sipas përkatësisë etnike është e domosdoshme për të parë ndikimin e elementit social (zakonet dhe traditat) në paraqitjen apo parandalimin e sëmundjes; 263/728 apo 36.1% e rasteve pozitive i përkasin komunitetit RAE kurse 465/728 apo 63.8% i përkasin komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë. Në zvogëlimin e numrit të rasteve nga sëmundjet vaksinëpreventabile kanë rëndësi fushatat e vetëdijësimit të popullatës dhe punëtorëve shëndetësor për rëndësinë e vaksinimit, e cila ndikon në përfshirjen sa më të madhe të popullatës. Poashtu, rëndësi të madhe ka vaksinimi në formë fushate, edukimi i prindërve, kontrolli i migrimit të popullatës (informatat nga komunat për personat e riatdhesuar, qendrat për azilkërkuës), shkëmbimi i informatave dhe përvojave ndërshtetërore.

## **Infeksionet e sistemit nervor qendror**

Situata epidemiologjike me infeksionet e sistemit nervor qendror në Kosovë, në pesë vitet e fundit (2016–2020) ka shënuar një trend stabil nëpër vite, ku janë raportuar 637 raste gjatë kësaj periudhe. Popullata më e afektuar kanë qenë fëmijët e grup-moshes 0-11 vjeç me më shumë se gjysmën e rasteve. Sipas gjinisë, nuk ka pas ndonjë dallim mes gjinisë mashkullore dhe femërore, e poashtu popullata urbane dhe rurale kanë qenë të përfshira në masë të njëjtë. Në bazë të të dhënave sipas diagnozës klinike, dominojnë meningjitet seroze me 55%, gjë që është tregues i përhapjes përmes rrugës fekalo-orale. Në vitin 2018, në raport me vitet paraprake është vërejtur një numër i shtuar i rasteve me meningoencefalit (27%) dhe meningjit purulent (23%). Duhet të intensifikohet promovimi dhe edukimi i jetës së shëndoshë, në veçanti i prindërve për kujdes të shtuar ndaj fëmijëve, rritja e kapaciteteve diagnostikuese laboratorike ndikon në zbulimin e hershëm të shkaktarit etiologjik, e cila mundëson edhe trajtimin e hershëm dhe korrekt. Trajtimi i duhur në raport me agjensin patologjik paraqet domosdoshmëri për hartimin e protokolleve klinike.

Sistemi i hershëm i raportimit (ALERT) i raportimit mundëson zbulimin e hershëm dhe ndërmarrjen e masave të kontrollës dhe kundërepidemike ndaj sëmundjes.

### **Infeksionet seksualisht transmise dhe HIV/AIDS**

Gjatë viteve 2014-2020 janë raportuar gjithsej 5192 raste të Infeksioneve seksualisht transmise. Të gjitha rastet e raportuara janë të konfirmuara në mënyrë laboratorike. Numri më i madh i rasteve të IST-ve të raportuara është i gjinisë femërore 3899 (75%), derisa i gjinisë mashkullore është 1293 (25%). Vetëm në vitin 2019 janë raportuar 1088 raste të IST-ve tek gjinia femërore. Për dallim nga IST tjera infeksioni me Gonorrhoea është raportuar më shumë tek gjinia mashkullore me 91%. Gjatë viteve 2014-2020 janë raportuar gjithsej 41 raste me HIV dhe AIDS dhe 7 kanë vdekur si pasojë e AIDS-it. Numri më i madh i rasteve me HIV i takon grup moshës 25-34 (35%), pastaj grup moshës 35-44 (30%), 45-54 (17%), grup moshës 0-15 vjeç (1%) etj. Sipas gjinisë më së shumti raste (72%) i takon gjinisë mashkullore dhe 28% të rasteve janë të gjinisë femërore. Rruga më e shpeshtë e përhapjes së HIV është rruga heteroseksuale 67%, 33% është përhapja e infeksionit në mesin e komunitetit MSM. Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se ne nuk kemi epidemi të gjeneralizuar apo të përqëndruar të infeksionit HIV. Për shkak të numrit jo të madh të rasteve me HIV dhe AIDS krahasuar me vendet tjera të Evropës Juglindore, mund të minimizohet dhe të nënçmohet problemi edhe pse ekzistojnë shumë faktor të rrezikut.

Rruga e përhapjes së hepatitit B, C, IST-ve dhe HIV është rruga seksuale, përmes gjakut, nga nëna tek fëmija, andaj është i rëndësishëm parandalimi, zbulimi i hershëm, trajtimi i duhur i këtyre infeksioneve paraqet domosdoshmëri për hartimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike. Raportimi me kohë dhe i kompletuar mundëson zbulimin e hershëm dhe ndërmarrjen e masave të kontrollës dhe kundërepidemike ndaj infeksionit. Gjatë raportimit të këtyre rasteve, duhet të ruhet konfidencialiteti i të dhënave, ku edhe rastet raportohen përmes kodit të caktuar. Përmes ligjit duhet të rregullohet bashkëpunimi për raportim me organizatat e shoqërisë civile, të cilat punojnë me popullatat e rrezikuara, si meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), personat që injektojnë droga (PID) dhe popullatat vulnerabile, kryesisht të rinjtë por edhe me grupe tjera.

### **Covid-19**

Nga data 08.02.2020 deri më 17.08.2022, u testuan gjithsej 1,957,566 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2. Testimi është bërë me qëllim që të gjurmohen të gjitha kontaktet e rasteve të konfirmuara të cilat janë gjetur në mënyrë aktive nga ekipet e IKSHPK-së. Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar gjithsej 268,639 raste ose 13.7% e mostrave të testuara janë pozitive. Deri më 17.08.2022, 260,606 raste ose 97.01% e të infektuarve janë shëruar, ndërsa aktualisht janë 5561319 raste aktive (2.07%). Deri më tani, janë regjistruar gjithsej 3,187 vdekje me një shkallë të letalitetit prej 1,18%. Në totalin e të prekurve me COVID-19, grup moshë më e prekur është 30-39 vjeç me 19%. Sipas grup moshës përqindja e të prekurve me COVID 19 është: 0-9 (1.9%), 10 - 19 (7.6%), 20-29 (17.1%), 30 - 39 (19%), 40 - 49 (17.7%), 50 - 59 (15.6%), 60 - 69 (12.2%), 70 - 79 vjeç (6.9%) mbi 80 vjeç (2.1%). Gjinia femërore prezenton me 52% krahasuar me atë mashkullore me 48%.

Paraqitja e rasteve sipas institucioneve është, profesionistët shëndetësor 3.14%, mësimdhënës 2.21%, policia 0.86%, FSK 0.18%, gardianë 0.02%, zjarrfikës 0.01%, të burgosur 0.01%, 93.51% janë raste të konfirmuara brenda familjeve dhe institucioneve publike dhe private. Nga punëtorët shëndetësor të prekur me COVID-19 janë mjekë 33.12%, infermierë 58.97%, farmacistë 6.05% dhe fizioterapeut 1.85%.

Për funksionimin efikas, real në kohë të sistemit të mbikëqyrjes, përpunimit dhe shkëmbimit e të dhënave, duhet të krijohet sistem i digjitalizuar për raportim nga të gjitha nivelet. Poashtu ky sistem duhet të mundësojë qasje të integruar mes IKShPK /Klinikave me COVID-19, laboratorit mikrobiologjik-IKShPK dhe të gjitha institucioneve të licencuara për COVID-19.

#### **4. GATISHMËRIA, REAGIMI DHE MENAXHIMI I KRIZAVE**

Funksioni Mbështetës Emergjent 8 (FME#8) i Planit të Reagimit Kombëtar (PRK) është finalizuar dhe aprovuar në vitin 2019. Në vitin 2020 bazuar në FME#8 të PRK-së është shpallur gjendja emergjente e shëndetit publik për pandeminë COVID-19. Pra, ky plan është aktivizuar me shfaqjen e gjendjes emergjente të shëndetit publik me Pandeminë COVID-19.

Meqenëse ka filluar rishikimi i PRK, rrjedhimisht pas aprovimit të PRK do të bëhet edhe rishikimi i FME#8. Meqenëse aktualisht nuk planifikohet rishikimi i PRK, rrjedhimisht nuk planifikohet as rishikimi i FME#8. Në kuadër të PV të programit për sëmundje ngjitëse, parashikohet hartimi i Planit operativ emergjent për shëndet publik. Gjithashtu në këtë plan planifikohet edhe hartimi i PSO për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente në shëndetin publik.

Vlerësohet së është e nevojshme që të organizohen ushtrime sipas skenareve që duhet përgatitur, me qëllim të testimit të planeve emergjente, duke përfshirë sektorë të ndryshëm.

Është e domosdoshme ngritja e kapaciteteve dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së Qendrës Operative Emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë. QOE në MSh duhet të pajiset me të gjitha mjete të nevojshme sipas Planeve emergjente; mjete komunikimi, kompjuter, harta, trajnime, etj. Në situatë normale QOE në MSh, është jo aktive. QOE aktivizohet në rast të një situatë emergjente kombëtare. QOE në IKShPK do të jetë e përhershme. QOE në IKShPK vazhdon veprimtarinë me intenzitet të ultë, por varësisht nga situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse aktiviteti i saj rritet.

#### **5. SISTEMI I MIKROBIOLOGJISË SË SHËNDETTIT PUBLIK**

Ofrimi i shërbimeve të mikrobiologjisë në sistemin publik në Kosovë bazohet në Departamentin e Mikrobiologjisë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës në Prishtinë dhe në laboratorët e mikrobiologjisë në gjashtë qendrat rajonale të shëndetit publik të Kosovës (Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Gjakovë). Gjatë vitit 2021 është themeluar shërbimi i

mikrobiologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me mbështetjen e Ambasadës Italiane në Prishtinë dhe ka filluar ofrimin e shërbimeve klinike të mikrobiologjisë. Gjithsej janë 28 specialistë të Mikrobiologjisë që punojnë në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (me qendra rajonale), 5 mikrobiologë në QKUK dhe 2 në Spitalin Rajonal në Pejë, me gjithsej 35 mikrobiologë brenda sistemit shëndetësor publik të Kosovës. Këta janë të gjithë fillimisht mjekë të cilët kanë kryer katër vite specializim në Mikrobiologji, kryesisht në periudhën kohore 2002-2018. Gjatë vitit 2020, si pjesë e aktiviteteve për të mbështetur reagimin e Kosovës ndaj COVID 19, një numër prej 24 mjekësh të rinj kanë filluar me pesë vite specializim në Mikrobiologji Mjekësore.

Qëllimi parësor i shërbimeve të mikrobiologjisë në IKSHP Kosovë dhe QKUK është ofrimi i shërbimeve laboratorike diagnostikuese për sëmundjet infektive për të tri nivelet e sistemit shëndetësor të Kosovës, krahas trajnimit të specializantëve të rinj si dhe implementimi i aktiviteteve shkencore (të cilat vazhdojnë të jenë të vogla dhe kryesisht të varura nga bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë). Siç është përmendur në raportin e vlerësimit teknik të ECDC-së, çështjet kryesore të hasura në lidhje me shërbimet e mikrobiologjisë në IKSHP të Kosovës janë mungesa e financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për laboratorët e mikrobiologjisë, numri i kufizuar i personelit, orari i shkurtër i punës si dhe kapacitetet e përgjithshme të kufizuara për të kryer shërbime mikrobiologjike.

Kjo është situata në të cilën Kosova ka hyrë në pandeminë e COVID 19 në vitin 2020. Për shkak të kapaciteteve të kufizuara laboratorike diagnostikuese për COVID 19 janë bërë përpjekje mbështetëse nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë për të rritur kapacitetet për testim me Real Time PCR në IKSHPK në Prishtinë dhe në qendrat rajonale të shëndetit publik. Mbështetja më e rëndësishme në këtë drejtim është dhënë nga granti i Bankës Botërore në vlerë prej 2.1 milionë USD për ngritjen e kapaciteteve testuese për COVID 19 me Real Time PCR në të gjashtë qendrat rajonale të shëndetit publik të Kosovës. Përmes këtij projekti janë siguruar instrumente RT PCR, makina të automatizuara ekstraktuese për ARN/ ADN, kabinete biosigurie të klasit 2, frigoriferë laboratorikë, ngrirës, centrifuga të kapaciteteve të ndryshme, aparate për testime serologjike dhe një numër i madh materialesh harxhuese laboratorike. Përveç kësaj, instrumente të tjera RT PCR dhe makina të automatizuara ekstraktuese dhe materiale harxhuese laboratorike i janë siguruar IKSHPK-së në Prishtinë nga USAID-i, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Fondacioni Soros në Kosovë dhe shumë donatorë të tjerë.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2020-2021 janë investuar përafërsisht 1.5 milionë euro në pajisje për laboratorët e mikrobiologjisë të IKSHP të Kosovës dhe qendrat rajonale të shëndetit publik nga Ministria e Shëndetësisë përmes financimit të Planit të Veprimit të Kosovës për Rezistencën Antimikrobike. Nëpërmjet këtyre mjeteve është blerë instrumenti NGS (MiSeq Illumina) dhe pajisje tjera përcjellëse për kryerje të sequencionimit të gjeneratës së ardhshme, MALDI-TOF instrument VITEK MS, shumë instrumente për gjenotipizimin e bakteve, sisteme të automatizuara të identifikimit të bakteve, etj. Pritet që të investohen 900,000.00 euro shtesë në

pajisje dhe infrastrukturë për IKSHP Kosovë nga Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2022 në kuadër të zbatimit të të njëjtit plan veprimi.

Prandaj, vitet 2020-2021 kanë qenë periudha kohore me investimin më të madh në historinë e mikrobiologjisë së Kosovës.

Në këtë drejtim, plani i veprimit 2022-2024 për zbatimin e rekomandimeve të pranishme në raportin teknik të ECDC për kapacitetet e vendit në mbikëqyrjen, parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse nga viti 2018, synon të shfrytëzojë këtë momentum pozitiv të viteve 2020-2021 dhe të vazhdojë investimet strategjike në forcimin e kapaciteteve të laboratorëve të mikrobiologjisë në Kosovë përmes rritjes së buxhetit në dispozicion, zgjerimit të orarit të punës për ofrimin e shërbimeve mikrobiologjike 24/7, zhvillimin dhe zbatimin e udhëzimeve zyrtare të Kosovës për diagnostikimin laboratorik të sëmundjeve ngjitëse të sistemit të mbikëqyrjes së Kosovës, krijimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorët e mikrobiologjisë përmes procesit të akreditimit dhe të sigurojë zbatimin e standardeve EUCAST në testimin e rezistencës antimikrobike të patogjenëve të izoluar.

Në këtë plan veprimi janë të pranishme 48 aktivitete të ndryshme, duke filluar nga rritja e buxhetit të rregullt për prokurimin e testeve dhe materialeve harxhuese për laboratorët e mikrobiologjisë, prokurimi i pajisjeve, rritja e infrastrukturës laboratorike përmes ndërtimit të objektit të ri bashkëkohor për laboratorët referentë kombëtare në IKSHP Prishtinë, zhvillimi i udhëzuesve për diagnostikimin laboratorik të sëmundjeve ngjitëse që janë pjesë e sistemit të mbikëqyrjes, zhvillimi i protokolleve për transportin e mostrave nga rajonet në IKSHP Prishtinë, ngritja e sistemit të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë për laboratorët e mikrobiologjisë, gamë e gjerë e trajnimeve si pjesë e edukimit të vazhdueshëm profesional si dhe studime shkencore për të kuptuar më mirë barrën e infeksioneve që nuk dihen mirë në këtë moment.

Angazhimi i mikrobiologëve, teknikëve të laboratorit, menaxhmentit, stafit mbështetës, si dhe partnerëve të tjerë, përfshirë këtu edhe aspektin tejet të rëndësishëm të mbështetjes nga zyrtarët drejtues në Ministrinë e Shëndetësisë është thelbësor në zbatimin e këtij plani veprimi.

## **6. PROGRAMET KOMBËTARE PËR SËMUNDJET**

### **6.1. Rezistenca antimikrobike dhe infeksionet gjatë kujdesit shëndetësor**

#### *Rezistenca antimikrobike*

Më 5.12.2018, Ministri i Shëndetësisë nënshkroi Planin e Veprimit për Rezistencën Antimikrobike për një periudhë tre vjeçare. Ky plan synonte vendosjen e një kornize të masave dhe veprimeve për të kufizuar shfaqjen dhe përhapjen e rezistencës antimikrobike në Kosovë. Aktivitetet e planifikuara të planit të veprimit janë në përputhje me Planin Global të Veprimit të OBSH-së për Rezistencën Antimikrobike dhe Konkluzionet e Këshillit të Evropës mbi Rezistencën

Antimikrobike. Plani ka 5 objektiva strategjike dhe 47 aktivitete. Bërthama kryesore e këtij plani të veprimi është programi i kujdestarisë së antimikrobikëve. Objektivat specifike të planit të veprimit për rezistencën antimikrobike janë forcimi i koordinimit ndërsektorial; fuqizimi i ndërgjegjësimit, edukimit dhe trajnimit të popullatës dhe punëtorëve shëndetësor; përmirësimi i kapaciteteve mbikqyrëse; optimizimi i përdorimit të antibiotikëve në mjekësinë humane dhe atë veterinare; parandalimi i infeksioneve dhe të promovimi i kërkimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në shtator 2019, Kosova përditësoi Listën Barnave Esenciale, me regjistrimin e klasifikimit të antibiotikëve sipas programit AWaRe të OBSH (Access, Watch and Reserve), i cili mbështet iniciativat e kujdestarisë së antimikrobikëve. Në vitin 2019, gjithsej 69% e antibiotikëve të përkisnin në Kosovë i përkisnin grupit access sipas AWaRe.

Të dhënat e konsumit të antimikrobikëve në Kosovë janë mbledhur në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kosovare të Pajisjeve dhe Produkteve Mjekësore. Të dhënat totale të përdorimit të antimikrobikëve në Kosovë, të analizuar sipas metodologjisë të OBSH-së (Doza Ditore të Përcaktuara/ 1,000 banorë/ditë (DID) dhe të publikuara më 2012 treguan se ky konsum ishte 26.3 DID.

Publikimi pasues pesëvjeçar i OBSH-së për konsumin e antibiotikëve në 45 shtete të Evropës, i publikuar në dhjetor 2018, tregoi se Kosova kishte ulje të konsiderueshme të konsumit të antibiotikëve prej gati 25%. (nga 26.3 DID në 20.1 DID). Faktorët kryesorë që ndikuan në këtë rënie të konsumit janë rritja e ndërgjegjësimit të popullatës dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor për RAM, puna e stafit shëndetësor, medias dhe angazhimi i qeverisë për të trajtuar RAM.

Korniza ligjore për monitorimin e RAM bazohet në Udhëzimin Administrativ 05/2011 për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore (neni 7; 1.4) dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Rezistencën Antimikrobike (objektivi specifik 1.3.- përmirësimi i kapacitetit të monitorimit të AMR).

Laboratorët e mikrobiologjisë klinike në Kosovë kanë marrë pjesë në programet ndërkombëtare të kontrollit të jashtëm të cilësisë (UK NEQAS dhe Universiteti i Antverpit), që nga viti 2013. Të gjithë laboratorët në Kosovë kanë përdorur metodologjinë e EUCAST si standard për kryerjen dhe interpretimin e testimit të ndjeshmërisë ndaj antibiotikëve që nga viti 2013.

Rrjeti CAESAR i OBSH mbledh rezultatet e testeve të ndjeshmërisë antimikrobike nga izolatet bakterore invazive (kulturat e gjakut dhe lëngu cerebrospinal) nga shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe ish-republikat e BRSS dhe Kosova është pjesë e këtij programi prej vitit 2014.

Linku për rrjetin CAESAR: <https://www.euro.who.int/en/health-topics/disease-prevention/antimicrobial-resistance/publications/2020/central-asian-and-european-surveillance-of-antimicrobial-resistance.-raporti-vjetor-2020>

Linku për GLASS: <https://www.who.int/publications/i/item/9789240027336>

Kosova është gjithashtu pjesë e disa projekteve kërkimore në fushën e AMR.

### SWOT analiza për rezistencën antimikrobike

| Përparësitë  | Mangësitë (sipas raportit të vlerësimit të ECDC)   |
|--|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zotimi dhe vullneti qeveritar</li> <li>• Lidershipi</li> <li>• Mbështja e institucioneve ndërkombëtare dhe donatorëve</li> <li>• Impakti i fuqishëm në shëndetin publik</li> <li>• Kost-relevanca</li> <li>• Mbështetja në strukturën dhe rrjetet ekzistuese</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka zbatim të planeve të reja të Veprimit për AMR &amp; HAI</li> <li>• Mungon zbatimi i rregulloreve që ndalojnë shitjen e antibiotikëve pa recetë</li> <li>• Nuk ka udhërrëfyes të miratuara zyrtarisht për praktikën e mirë klinike ose rekomandime bazë për përdorimin racional të antimikrobikëve.</li> <li>• Kapaciteti laboratorik për të përcaktuar ndjeshmërinë antimikrobike është i pamjaftueshëm.</li> <li>• Të dhënat për konsumin antimikrobik në kujdesin shëndetësor janë të kufizuara.</li> <li>• Ekziston një mungesë e avokimit për publikun e gjerë për përdorimin racional të antimikrobikëve.</li> <li>• Ka pak të dhëna dhe informacione për përdorimin e antimikrobikëve të kafshët.</li> <li>• Baza rregullatore për infeksionet spitalore nuk është përditësuar</li> <li>• Spitalet kanë staf të pamjaftueshëm të dedikuar për kontrollin e IAL.</li> <li>• Stigma ose faji pas zbulimit të HAI.</li> <li>• Mungesa e Procedurave Standarde të Operacionit për parandalimin e HAI.</li> <li>• Infrastruktura e papërshtatshme spitalore dhe mungesa e furnizimeve për parandalimin dhe kontrollin e HAI.</li> </ul> |
| Mundësitë  | Kërcënimet   |

|   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Legjislacioni</li> <li>• Ulja e shpenzimeve</li> <li>• Zbulimi i hershëm dhe intervenimet</li> <li>• Përvoja e suksesshme në planin paraprak 5 vjeçar</li> <li>• Ekziston platformë e gatshme e koordinimit “Një Shëndet”</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mangësitë buxhetore</li> <li>• Moszbatimi i infrastrukturës ligjore për shitjen e antibiotikëve pa recetë</li> <li>• Rezistenca nga industria farmaceutike</li> <li>• Dyshimet në korrupcion</li> <li>• Tregu i zi-kontrabanda</li> </ul> |
|---|--|

#### AKTIVITETET E PLANIT TË VEPRIMIT PËR RAM TË REALIZUARA GJATË VITIT 2019-21

| AKTIVITETI SIPAS PV   | REZULTATET  |
|---|---|
| 1.1.1 Rritja e bashkëpunimit ndërsektorial në kontrollin e rezistencës antimikrobike  | Nxjerrja e vendimit nga MSH për themelimin e GNKRA  |
| 1.1.3. Krijimi i strukturës kombëtare koordinuese për mbikëqyrjen e rezistencës antimikrobike   | Vendimi nga MSh për emërimin e Laboratorit Referent për Rezistencën Antimikrobike dhe Komiteti për Testim të Ndjeshmërisë ndaj Antibiotikëve Termat e Referencës të përgatitura dhe të miratuara                  |
| 1.1.4. Fuqizimi i mbikëqyrjes së zingjirit të furnizimit farmaceutik, duke përfshirë sistemin e prokurimit, furnizimit dhe menaxhimit | Testimi vjetor i cilësisë së antibiotikut të caktuar (INN) nga të gjitha nëngrupet e antibiotikëve të përdorur në vend (12 antibiotikë të testuar)<br><br>Memorandum Bashkëpunimi i nënshkruar nga GNKRA me AKPPM |
| 1.1.9. Hartimi i procedurave standard operative për diagnozën laboratorike dhe parandalimin e infeksioneve                            | Procedurat standarde operative të hartuara dhe zbatuara (6 procedura standard operative)  |
| 1.2.1. Promovimi i përdorimit korrekt të antibiotikëve tek popullata dhe punëtorët shëndetësorë                                       | Finalizimi i fushatës për RAM, materialet promovuese të shpërndara në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësorë; Ligjëratat e mbajtura për QKMF   |
| 1.2.2. Shënimi i javës globale të vetëdijesimit për antibiotikë, e cila organizohet nga OBSH çdo vit gjatë javës së tretë të Nëntorit | Java Globale e realizuar për Vetëdijësimin për Antibiotikët   |

|  |   |
|--|---|
| 1.2.3. Lansimi dhe zbatimi i pakos edukative E-bug   | Pakoja është lansuar në prill të vitit 2020   |
| 1.2.4. Mbajtja e ligjeratave për RAM në takimet profesionale shkencore në Kosovë   | Partneriteti me shoqatat profesionale dhe grupet private mjekësore e veterinarë për ta adresuar AMR (Shoqatat e Mjekëve familjarë, pediatërve, kirurgëve, infektologëve, gjinekologëve, farmacistëve, mikrobiologëve; Asociacionit të Mjekëve të sektorit privat; Shoqatës së Bujqve, AVUK etj.)-   |
| 1.2.5. Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë në KPSH për programin e Kujdesit për antibiotikë                                       | Mbajtja e trajnimeve në të gjitha rajonet   |
| 1.2.6. Trajnimi i punëtorëve shëndetësorë në spitalet e Kosovës për programin e përkujdeses me antibiotikë                       | Trajnimet e mbajtura gjatë 2019   |
| 1.2.8. Trajnimi i mikrobiologëve të Kosovës me përditësimet e testimit të antibiogramit dhe diagnostikën e infeksioneve anaerobe | Mbajtja e një trajnimi të mikrobiologëve  |
| 1.3.1. Mbikqyrja e profilit të rezistencës ndaj antimikrobikëve në laboratorët e mikrobiologjisë klinike                         | Raporti vjetor për RAM për mostrat klinike invazive (CAESAR) dhe joinvazive i publikuar; Raportet e antibiogramit për mikrobet më të shpeshta patogjene në Departamente të veçanta përbrenda institucioneve; Përgatitja e katër (4) procedurave standard operative për fenotipizim dhe gjenotipizim |
| 1.3.3. Kontrolli i jashtëm dhe i brendshëm i cilësisë së laboratoreve  | Të gjitha laboratorët rajonale kanë soje referente të baktereve për kontroll të cilësisë  |
| 1.4.1. Krijimi i programit të kujdestarisë së antibiotikëve  | Termet e referencës për programin e KA të hartuara dhe programi zyrtarisht i themeluar në qershor 2021  |
| 1.4.2. Monitorimi i zbatimit të ligjit për ndalimin e shitjes së antibiotikëve pa recetë të mjekut                               | Barnatorët e inspektuara për zbatimin e ligjit dhe masat e ndërmarra përkatëse nga Inspektorati (gjoba dhe mbyllje të barnatoreve)  |

|   |  |
|---|--|
| 1.4.7. Sigurimi i shërbimeve adekuate të diagnostikës mikrobiologjike (teste plotësuese diagnostike, teste për sistemet automatike gjenetike, Strep testi dhe diagnostika anaerobe) | Pajisjet dhe testet diagnostike të siguruara mjekësore për adresimin e RAM (aparaturë dhe reagensa). |
| 1.5.5. Gjenotipizimi i izolateve multirezistente  | Është siguruar informata për gjenotipizim  |
| 1.5.6. Hulumentimi në barnatoret komunitare për dispensimin e antibiotikëve pa recetë të mjekut   | Hulumtimi i finalizuar   |
| 1.5.8. Fuqizimi i lidhjeve me shtetet tjera që zbatojnë planin e veprimit të AMR  | Bashkëpunimi rajonal e ndërkombëtar  |
| 1.5.10. Shkëmbimi i rezultateve të mbikqyrjes me organizatat ndërkombëtare  | Shkëmbimi me OBSH, ECDC  |

**Investimet qeveritare në infrastrukturën laboratorike të mikrobiologjisë së shëndetit publik siç kërkohet nga PNV për AMR (>1 milion €)**

- Sekuencues - next Generation Sequencing (NGS),
- Sistemi automatik me kompleksin multipleksi RT-PCR
- Analizues plotësisht i automatizuar i hemokulturave
- Analizues imunokimik plotësisht i automatizuar për depistimin e gjakut
- Sistemi automatik i identifikimit mikrobiologjik dhe testimit të ndjeshmërisë për bakteret dhe fungjet
- Sistemi automatik i monitorimit mjedisor në kohë reale për parametrat fizikë
- Sistem i plotë i përgatitjes së mediave, me autoklavë dhe stacione grumbulluese për pllaka, tuba dhe shishe të gatshme për përdorim
- Sistemi i diagnostikimit molekular plotësisht i automatizuar dhe i integruar i bazuar në teknologjinë e kartelave
- Sistemi i analizës së fragmentimeve gjenetike
- Sistemi plotësisht i automatizuar për ndjeshmërinë antimikrobike
- Lexues automatik i zonës së frenimit & hollues automatik

### *Infeksionet gjatë kujdesit shëndetësor*

- Plani Kombëtar i Veprimit për parandalimin e infeksioneve të fituara gjatë kujdesit shëndetësor është përgatitur dhe dorëzuar në MSh qysh në tetor të vitit 2018. Por, nuk është miratuar deri në dhjetor 2020.
- Dymbëdhjetë Procedurat Standarde të Operative për procedurat kryesore spitalore, të cilat kërkohen në parandalimin e HAI janë në përfundim e sipër. Këto procedura janë: VAP; Sepsa; ITU; SSI; Pastrimi, sterilizimi dhe dezinfektimi; profilaksia me antibiotikë para ndërhyrjeve kirurgjikale; Masat parandaluese të izolimit; Menaxhimi i mbetjeve mjekësore; Higjiena e duarve; Raportimi i incidenteve në vendin e punës; Kujdestaria antimikrobike dhe Kujdesi për shtratin e pacientit.
- Gjatë pandemisë Covid-19 janë zhvilluar trajnime për parandalim dhe kontrollë të infeksioneve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

## **6.2. Sëmundjet re-emergjente që barten përmes vektorëve**

### *Sëmundjet re-emergjente*

Në vitet e fundit në Kosovë regjistrohen edhe sëmundjet re-emergjente, si sëmundjet e Lyme, Ëest Nile virus, Leishmaniza, Legionelloza, Leptospiroza, të cilat nuk raportohen në numër të madh, mirëpo paraqesin rrezik për përhapje të vazhdueshme. Në Kosovë në periudhën pesë vjeçare 2016-2020 janë raportuar gjithsej 18 raste të sëmundjes Lyme, 16 raste ËNV, 8 raste të Leishmaniazës, 13 raste të Leptospirozës dhe 7 raste të Malarjës. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, 2018 janë raportuar 14 raste të ËNV-së me Incidencë 0.8/100 000. Këto raste raportohen nga 7 komuna dhe numri më i lartë raportohet nga komuna e Prishtinës (5 raste, Incidencë 2.4/100 000 banorë), Drenasit (4 raste, incidencë 6.6/100 000 banorë), dhe komunat e Gjilanit, Malishevës, Vitisë, Skenderajit dhe Fushë Kosovës me nga 1 rast.

### *Ethet Hemorragjike Krime Kongo dhe Ethet Hemorragjike me Sindromë veshkore*

Kosova është zonë endemike për ethet hemorragjike Krime Kongo dhe ato me sindrom veshkor. Që nga viti 2014 deri më 2019 nuk është regjistruar asnjë rast me fatalitet nga EHKK, ndësa në vitin 2020 është regjistruar një rast me fatalitet prandaj këto sëmundje kërkojnë vigjilencë të shtuar dhe mbikëqyrje të vazhdueshme meqë janë sëmundje me patogjenitet dhe letalitet të lartë. Në periudhën kohore 2016-2020 janë raportuar gjithsej 4 raste të Etheve Hemorragjike Krime Kongo. Të gjitha rastet janë të konfirmuara në laboratorin e IKSHPK. Në vitin 2017 nuk është regjistruar asnjë rast i konfirmuar i EHKK, ndërsa në vitin 2016, 2018, 2019 dhe 2020 janë regjistruar nga një rast. Të gjitha rastet e konfirmuar me EHKK janë të gjinisë mashkullore dhe grup mosha 9-14 vjeç (1 rast), 25-49 vjeç (1 rast), 50-65 (2 raste). Sipas profesionit numër më i madh i rasteve janë bujq (3 raste) dhe (1 rast) nxënës. Të gjitha rastet e konfirmuara të EHKK janë nga zonat rurale.

Në periudhën kohore 2016-2020 janë raportuar 18 raste EHSV, numër më i madh i rasteve është raportuar në vitin 2017 (7 raste), 2016 dhe 2018 me nga (4 raste) dhe viti 2019 (3raste). Sipas grup moshës - numër më i madh i rasteve i takon grup moshës 15-34 (7 raste), 35-49 (6 raste), 9-14 vjeç (2rast), 50-64 (1raste), mbi 65 vjeç (2 raste) dhe ndërsa sipas gjinisë numër më i madh i takon gjinisë mashkullore 10 raste dhe 8 raste gjinisë femërore. Numri më i madh i rasteve janë amvise (7 raste) dhe punëtorë (5 raste) nxënës (2 raste), student (2raste) dhe profesionet tjera me nga 1rast (polic, muzicjent). Numri më i madh i takon zonave rurale 12 raste ose 66.66% ndersa 6 raste ose 33.33,2% janë nga zonat urbane, por të cilët kanë qëndruar në bjeshkë për qëllim të rekreacionit ose punës. Marrja e masave të kontrollit në zonat rurale duhet të bëhet në bashkëpunim ndërinstytucional, si përmes komisioneve ndërministrrore, shërbimit kombëtar të inteligjencës për raportim të ndërsjelle të rasteve. Poashtu rëndësi të veçantë ka edhe raportimi ndërkufitar i paraparë më RrNSh, si p.sh. fshatrat kufitare me Republikën e Shqipërisë kanë raste me ethe hemorragjike Krime Kongo, të cilat paraqesin rrezik të përhapjes në mes shteteve.

### 6.3. Sëmundjet që barten përmes ushqimit

Sëmundjet gastrointestinale të raportuara si diare akute, në pesë vitet e fundit (2016 – 2020) në Kosovë janë regjistruar në total 355 929 raste. Viti 2017 dhe 2019 kanë shënuar numrin më të madh të rasteve me 91 312 respektivisht 87635 raste. Moshat më të prekura janë ato të femijëve dhe moshat e reja, me mbi 70% të rasteve. Sëmundjet të cilat barten me ushqim shfaqen në formë sporadike dhe në formë të epidemive, qoftë kolektive apo familjare. Në pesë vitet e fundit janë regjistruar 53 epidemi të helmimeve me ushqim, ku janë përfshirë 594 persona, 284 prej tyre janë hospitalizuar dhe mbi 5 177 persona kanë qenë të ekspozuar. Shkaktari është izoluar në më shumë se gjysmën e epidemive, ku dominon infeksioni me Salmonella enteritidis si në mostra humane si dhe ato të ushqimit.

Moshat më të prekura janë 5-44 vjeç, gjë që flet edhe për moshat të cilat konsumojnë ushqim nëpër restorane. Në aspektin gjinor ka dallim të vogël, gjinia mashkullore është më e prekur (55%). Sipas vendbanimit, komunat me më shumë epidemi janë Prishtina dhe Prizreni, ndërsa dominojnë zonat urbane. Shumica e epidemive në zonat urbane i takon epidemive kolektive, ku ushqimi konsumohet në fast-food, qebaptore, restorane, ëmbëltore etj. Për zbulimin e hershëm të këtyre rasteve është i domosdoshëm bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për paraqitjen e sëmundjeve ngjitëse, ku sipas nenit 15 Shërbimi veterinar është i obliguar që menjëherë të paraqes çdo sëmundje ngjitëse tek IKSHP dhe ISK po qe se konstaton sëmundjen apo ngordhjen e kafshëve dhe gjatë kontrollave sanitare të higjienës në reastorane të raportojnë në IKShPK.

### Zoonozat

Republika e Kosovës është zonë endemike për zoonoza si bruceloza dhe tularemia. Nga viti 2016-2020 janë raportuar gjithsej 105 raste me brucelozë. Numri i rasteve të raportuara është i ngjashëm nëpër vite, pra në vitin 2016 me 26 raste ose Mb 1.4/100 000 banorë deri sa në vitin 2020 me 6 raste ose Mb 0.33/100 000 banore. Raste këto të raportuara në formë të epidemive kryesisht të

fermave të vogla dhe atyre mesatare dhe përfshirjen e fermerëve si profesionin më të atakuar. Tularemia është sëmundje endemike në Kosovë që nga viti 2001. Epidemia e parë është regjistruar në vitin 1999 (12.2 raste/100.000 banorë), ndërsa në vitin 2001 është regjistruar epidemia me 17.04 raste/100.000 banorë). Pas këtyre dy epidemive, në vitet në vijim janë raportuar raste sporadike deri në vitin 2014/2015, kur u rishfaq epidemia e tularemisë në nivel vendi me 26.4 raste/100.000 banorë me pikun e epidemisë në janar 2015 dhe si epidemi e shpallur në nivel vendi në shkurt të vitit 2015.

Nga viti 2016-2020 janë raportuar gjithsej 95 raste me tularemi. Numri i rasteve të raportuara është i ngjashëm nëpër vite, më tepër rastet i takojnë grupmoshës 15-44 vjeç me 44.7% dhe sipas profesionit më të prekur janë amviset me 20%, nxënësit 15% dhe bujqit/punëtorët me 14.7%. Tularemia paraqet ende problem në shëndetin publik, duke patur parasysh regjistrimin e rasteve çdo vit duke shkaktuar humbje ekonomike familjare dhe kolektive.

Sa i përket sëmundjeve që përhapen me ushqim, zoonotike dhe transmise është i domosdoshëm bashkëpunimi me AUV-in në konceptin 'One Health' duke filluar nga shpërndarja e informatave dhe përgjigje të përbashkët epidemiologjike, me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse me theks të veçantë zoonozave dhe ruajtjen e shëndetit të popullatës, kafshëve dhe mjedisit. Fuqizimi i bashkëpunimit përmes ligjit për sëmundje të veçanta, si zoonozat mund të ndërtohen sisteme të integruara dhe të përbashkëta të mbikëqyrjes epidemiologjike humane dhe veterinarë dhe për këtë qëllim duhet të hartohen përkufizimet e rastit dhe metodat e mbikëqyrjes së përbashkët, për aq sa është e mundur.

#### **6.4. HIV, infeksionet seksualisht transmise (IST) DHE sëmundjet që barten përmes gjakut**

Ministria e Shëndetësisë vazhdon të siguroj terapinë TAR. Testet për diagnostikim të HIV-it për testet e shpejta për Qendrat për Këshillim dhe Testim (KTV) për HIV, ndërsa konfirmimi i infeksionit me HIV bëhet me ëestern blood në IKShPK. Personat që janë të infektuar me HIV dhe janë në trajtim me terapinë TAR, monitorohen përmes testimeve të; Ngarkesës Virale, CD4 dhe testit të rezistencës. Plani i veprimit për HIV&TB 2022-2024 është në fazën e hartimit nga Ministria e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë, duke e respektuar rregulloren e Qeverisë nr. 04-2017 mund të përkrahë shoqërinë civile me projekte afat shkurtra, 6 muaj deri në një vjet për parandalimin e HIV-it, përmes thirrjes publike për aplikim. Por megjithatë, duhet të shtohet kujdesi për popullatat kyçe, sidomos të; meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), Punëtorët e Seksit Komercial (PSK), përdoruesit e drogave injektuese(PDI), në parandalimin e HIV-i. Në vitin 2019 është rishikuar dhe nënshkruar *Udhëzimi Administrativ nr. 1-2019 për Veprimtarinë, Strukturën dhe Funksionet e Shërbimeve Shëndetësore për HIV/AIDS*.

Qendra për Këshillim dhe Testim (KTV) në Klinikën Infektive, duhet të fuqizohet më shumë duke krijuar kushte më të mira punë dhe qasje më të mirë për klientët. Kjo, me qëllim të rritjes së

sigurisë së klientëve në parandalimin e stigmës. Disa nga OJQ-të që punojnë me popullata kyçe (MSM, PDI etj) kanë Qendrat për Këshillim dhe Testim (KTV) për HIV. Laboratorët private të cilat kryejnë testet për HIV, duhet të raportojnë të gjitha rastet pozitive, në IKShP me qëllim të konfirmimit të rastit e që personat të konfirmuar HIV pozitiv duhet të i nënshtrohen trajtimit dhe mbikëqyrjes. Duhet të fuqizohen laboratorët në IKShPK për diagnostikim të IST-ve. Gjithashtu duhet të hartohen udhëzues dhe PSO për diagnostikim, trajtim dhe mbikëqyrje.

Duhet të ngritën kapacitetet për kryerjen e testimeve laboratorike për diagnozë të hepatiteve virale, në të gjitha laboratorët e Qendrave e Shëndetit të Publik (QSHP) dhe IKShPK dhe fuqizimi i mbikëqyrjes së Hepatit C.

### **Hepatiti B dhe C**

Gjate periudhës 2017-2020 janë raportuar gjithsej 267 raste akute të Hepatitit B. Numër më i madh i rasteve është raportuar në vitin 2017 (83 raste), 2018 (80 raste), 2019 (36 raste) dhe në vitin 2020 (68 raste). Të gjitha rastet janë të konfirmuara në laboratorin e IKShPK. Sipas gjinisë numër më i madh i rasteve i takon gjinisë mashkullore 60% dhe 40% gjinia femërore, sipas grup moshës numër më i madh i rasteve i takon grup moshës mbi 40 vjeç. Në periudhën kohore 2017-2020 janë raportuar 26 raste akute me Hepatit C. Numri më i madh i rasteve është raportuar në vitin 2018 dhe 2019 me nga (11 raste), 2017 (3 raste) dhe në vitin 2020 me vetëm (1 rast). Sipas gjinisë numër më i madh i rasteve i takon gjinisë mashkullore 56% dhe 44% gjinia femërore, ndërsa sipas grup moshës numër më i madh i rasteve i takon grup moshës mbi 55 vjeç. Sa i përket grupeve të rrezikut, prevalenca e personave që injektojnë droga, sipas hulumtimit të vitit 2018 në Kosovë rezulton me 24% në hepatit C.

### **6.6. Tuberkulozi**

Ministria e Shëndetësisë prej vitit 2017-2018 përmes Marrëveshjes me CDF dhe prej 2019 e vazhdim përmes Marrëveshjes me UNICEF ka bërë të mundur planifikimin, prokurimin dhe blerjen e barnave ATB në GDF me kosto të ultë dhe cilësi të lartë si parakusht për trajtimin e pacientëve me TB. Këto barna përfshijnë terapinë e Linjës së parë FLD, terapinë e Linjes së dytë SLD dhe reagensat laboratorik për BK-a, të lëngët dhe të ngurtë.

Po ashtu përmes buxhetit historik dhe Kornizës Afatshkurtër dhe Afatmesme të Financimit nga MSh dhe MF janë të përfshira, pagesat e mjekeve pulmolog, infermierëve, laborantëve, mjekëve familjarë, infrastruktura, komunaliet.

Janë planifikuar gjithashtu edhe mbështetja e OJQ-ve, bazuar në UA 04/2017 për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme e sidomos sa i përket zbulimit aktiv të rasteve me TB. Plani i veprimit 2022-2024 i cili po hartohet do të planifikoj gjithashtu edhe kalimin gradual të aktiviteteve që kanë të bëjnë me trajnimet, EVP, mbështetjen e trajtimit etj si pjesë e menaxhimit të TB hap pas hapi.

Sfidë përbën mbajtja e strukturës vertikale të trajtimit në të tre nivelet e shërbimit – parësor, dytësor dhe tretësor. Për këtë arsye planifikohet mundësia e përfshirjes dhe integritit sa më shumë të Kujdesit Parësor Shëndetësor, e kërkuar kjo edhe nga rekomandimet e OBSH-së. Bazuar në Doracakun e përgatitur në vitin 2018, “Menaxhimi i TB në KPSH” kanë filluar dhe po mbahen një numër i madh i trajnimeve në KPSH me mjekë familjarë dhe infermiere familjare.

Shembuj të integritit të shërbimeve e sidomos në KPSH është Njësia për Sëmundje të Mushëkrive dhe TB në Prishtinë dhe Lipjan, ku pacientët me TB menaxhohen nga mjekët familjarë. Në 2022 është planifikuar të hartohet edhe “Menaxhimi i TB në KPSH” si dhe përgatitja e një qarkoreje informative për menaxhimin e TB në institucionet shëndetësore publike dhe jopublike në Kosovë. Gjatë vitit 2018 për QKUK /Klinikën e Pulmologjisë dhe Njesitë për TB në regjione janë blerë UV dhe Hepatofiltra si dhe kabinetet e Biosafety për të parandaluar përhapjen e infeksionit të TB.

Poashtu, gjatë vitit 2021 janë bërë ndërhyrje/ rikonstruksione në QKUK/Klinikën e Pulmologjisë, SR të Gjilanit /Klinika e Pulmos dhe SR/Prizren /Klinika e Pulmos. Është rifunksionalizuar Njësia për MDR /TB në SR të Pejës, pas kalimit të pikut të Pandemisë COVID-19.

#### **6.7. Sëmundjet vaksinë parandaluese**

Imunizimi është një nga fushat e rëndësishme strategjike për shëndet publik në Kosovë. Një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës është zbatimi i programit të zgjëruar të imunizimit me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse vaksinë parandaluese, duke synuar përfshirjen e plotë të të gjitha komuniteteve.

Programi i imunizimit konsiderohet si proces i suksesshëm në kuadër të fushës së shëndetit publik në Kosovë. Ministria e Shëndetësisë ka siguruar qëndrueshmëri financiare për programin e zgjëruar të imunizimit (PZI) përmes vaksinimit. Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë publike (IKShPK), si mbikëqyrës i zbatimit të programit si dhe Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor si institucione zbatuese është siguruar qëndrueshmëria e këtij programi, në përgjithësi.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) është institucioni përgjegjës për zhvillimin dhe rishikimin e politikave të imunizimit, si dhe menaxhon zbatimin e programit. Qenrat Rajonale të Shëndetit Publik (QRShP) janë përgjegjëse për mbikëqyrje dhe përgjegje epidemiologjike, analizën e të dhënave të grumbulluara dhe monitorimin e performancës së imunizimit. Programi i imunizimit është i rregulluar dhe i obliguar bazuar në aktet ligjore në fuqi, realizohet pa pagesë.

Megjithë sfidat gjatë zbatimit të programit të imunizimit, përfshirë ato strukturale, financiare, gjeografike dhe menaxheriale në ofrimin e qasjes universale në imunizim, raportet tregojnë se në Kosovë, shkalla e përfshirjes në imunizim është mjaft e kënaqshme. Megjithatë edhe përkundër sukseseve evidente kanë treguar një nivel jo të kënaqshëm të mbulimit me vaksinë kundër fruthit, shytave-parotitit dhe rubeolës (MMR1).

Aktivitetet e paraqitura në Planin Strategjik 2022-2024 ka për synim përcaktimin e drejtimeve për përfshirjen me imunizim të gjithë popullatën e Republikës së Kosovës për t'i mbrojtur nga sëmundjet që mund të parandalohen përmes vaksinimit si dhe sigurimin e mbulueshmërisë sa më të madhe me vaksinim si dhe ka për qëllim të përforcoj shërbimet cilësore të imunizimit, fuqizimin e kapaciteve të profesionistëve shëndetësor, edukimin dhe promovimin shëndetësor dhe prezantimin e vaksinave të reja në parandalim të sëmundjeve.

Qëllimi e mbulueshmërisë me vaksinim janë që të arrihet të paktën 95% të mbulueshmërisë në mbarë vendin me të gjitha antigjenet, si dhe arritjen e të paktën 90% të mbulueshmërisë në nivel lokal duke përfshirë të gjitha komunitetet.

Shkalla e përfshirjes me të gjitha vaksinat është e lartë, por sfida mbetet arritja e mbulueshmërisë më e ulët e imunizimit në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Për arritjen e këtij synimi Plani Strategjik në pjesës e Sëmundjeve Vaksinë Parandaluese 2022-2024 do të fokusohet në realizimin e aktiviteteve:

6.5. Hartimi i strategjisë ose planit të veprimit kombëtar në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare, për të zgjeruar vaksinimin kundër gripit sezonal te punëtorëve shëndetësor si dhe në popullatën e përgjithëshme.

6.7.1. Plotësim ndryshimi dhe implementimi i Planit Shumëvjeçar të Programit Kombëtar të Imunizimit.

6.7.2. Të kryhet vlerësimi për vaksinat kundër rotavirusit, virusit të papillomës njerëzore dhe pneumokokut me qëllim të implementimit në programin kombëtar.

6.7.3. Forcimi i mekanizmave për identifikimin gjithëpërfshirës të grupeve të marginalizuara, zhvillo mekanizma për t'i arritur ato dhe për të krijuar avokim efektiv për këto grupe.

6.7.4. Forcimi i mekanizmave për identifikimin e fëmijëve të pa vaksinuar si dhe përmirësimin e cilësisë të të dhënave për vlerësim të mbulueshmërisë me vaksinim.

6.7.5 Sigurimi i stafit të mjaftueshëm në kujdesin parësor shëndetësor për mbarëvajtjen e procesit të vaksinimit, realizimi i përtërirjes së zinxhirit të ftohtë në të gjitha nivelet.

Adresimi i sfidave me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të programit të imunizimit parashihet të bëhet përmes ngritjes së kapaciteve, promovimit dhe edukimit shëndetësor, koordinimit ndërinstytucional dhe sigurimit të financimit të qëndrueshëm.

Plani i veprimit të këtij dokumenti përmban aktivitetet, indikatorët, mjetet për realizim të aktiviteteve, afatin kohor, koston e zbatimit dhe bartësin e kostos si dhe institucionet dhe përgjegjësit e tjerë për realizim të aktiviteteve.

## **5. OBJEKTIVAT**

### **Objektiva strategjike I**

#### **PARANDALIMI DHE KONTROLLI I SËMUNDJEVE NGJITËSE**

#### **Objektivat specifike**

- 1. Përmirësimi i qeverisjes në fushën e sëmundjeve ngjitëse**
- 2. Qasje progresive në Planin e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore**
- 3. Përmirësimi i mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse**
- 4. Gatishmeria dhe reagimi**
- 5. Ngritja e kapaciteteve të laboratorëve mikrobiologjik në Kosovë**

## 6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit rregullohen përmes strukture së menaxhimit të zbatimit ku përfshihen rolet dhe përgjegjësitë e definuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera kyçe që janë të obliguara të bashkëpunojnë në zbatim.

Qëllimi i sistemit të Monitorimit dhe vlerësimit (M&V) është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Programit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në të dhënat zyrtare të cilat mundësojnë marrjen e vendimeve të bazuara në dëshmi për MSh-në.

Doracaku i Monitorimit dhe vlerësimit (M&V), është instrument i cili ofron përshkrimin e hollësishëm të sistemit të M&V, i zhvilluar për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të Programit të SN 2022-2032 Dokumenti përfshin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me strukturën dhe funksionimin e sistemit të M&V gjatë pesë viteve të ardhshme, me mundësi të rishikimit.

Doracaku shfrytëzohet nga të gjithë akterët e përfshirë në sistemin e M&V, ku gjejnë informatat e nevojshme për të përmbushur me sukses rolin e tyre në mbledhjen, agregimin, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave.

Ministria e Shëndetësisë, përmes mekanizmave të krijuar do të monitoroj zbatimin e Programit duke shfrytëzuar metodologji, mjete dhe instrumente të qarta për ta matur zbatimin e Programit.

Qëllimet e sistemit të M&V janë:

- T'i ofrojë informata Ministrisë së Shëndetësisë dhe hisedarëve tjerë, lidhur me përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të Programit të sëmundjeve ngjitëse, me qëllim që të mundësojë politikëbërjen e bazuar në dëshmi, ndihmojë vendimmarrjen si dhe ndërmarrjen e masave të duhura sipas nevojës;
- Të harmonizojë, standardizojë dhe thjeshtësojë procedurat e mbledhjes, agregimit dhe shpërndarjes së të dhënave ndërmjet institucioneve shëndetësore;
- Të rrisë ndërgjegjësimin dhe përdorimin e qasjes së monitorimit dhe vlerësimit në sektor;
- Të forcojë rolin drejtues të Ministrisë së Shëndetësisë në sektor si vendimmarrëse dhe udhëheqëse e strategjisë.

Parimet udhëheqëse gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit janë:

### **Gjithëpërfshirja**

Në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë sektorët dhe institucionet hisedare në SSSH. Gjatë aktivitetit të krijimit të sistemit të monitorimit, si parim udhëheqës ka qenë që të veprohet sipas strukturës organizative të sektorit të shëndetësisë të Kosovës. Sistemi i M&V mbështet fuqizimin organizativ të sektorit duke vlerësuar kompetencat e veçanta dhe historinë e gjatë dhe të rrënjosur të institucioneve shëndetësore. Si komponent më i prekshëm i ngritjes së kapaciteteve institucionale janë procedurat e brendshme dhe mekanizmat administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Sistemi i M&V synon t'i përforcojë ato instrumente, ku në këtë drejtim respekton procedurat administrative ekzistuese. Theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe të sektorëve tjerë të përfshirë.

### **Udhëheqja**

Ministria e Shëndetësisë ka rol udhëheqës në procesin e monitorimit dhe vlerësimit, që është e përcaktuar me aktet ligjore në fuqi.

### **Thjeshtësia**

Sistemi i M&V është dizajnuar për të qenë sa më i thjeshtë. Të kuptuarit dhe pjesëmarrja në përcjelljen e rrjedhës së informatave, procedurave dhe të dhënave duhet të jetë e shpejtë dhe e lehtë për çdo përdorues të doracakut.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve të Planit të veprimit të Programit për sëmudje ngjitëse do të realizohet edhe në mënyrë periodike, dy herë në vit edhe në ECDC dhe Komision evropian, obligime këto të cilat dalin nga agjenda evropiane.

**7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL**

**8. SHTOJCA 1**

**Plani i veprimit**

## SHTOJCA 1 - PLANI I VEPRIMIT

### 1.QEVERISJA

| OBJEKTIVI STRATEGJIK - FUQIZIMI I SISTEMIT TË MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE NGJITËSE                        |  |  |                |           |           |                     |                        |                         |  |  |
|--|--|--|----------------|-----------|-----------|---------------------|------------------------|-------------------------|--|--|
| Objektivi specifik 1 - Përmirësimi i qeverisjes në fushën e sëmundjeve ngjitëse  |  | Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit |                |           |           | Baza 2022           | Caku 2023              | Caku 2025               |  |  |
| Rekomandimi<br>ECDC  | Aktiviteti                                 | Afati i zbatimit                                     | Kostoja totale |           |           | Burimi i financimit | Institucioni udhëheqës | Institucioni mbështetës | Produkti   |  |
|  |  |  | Viti 2023      | Viti 2024 | Viti 2025 |                     |                        |                         |  |  |
| 1.1.1 Zbatimi i të gjitha akteve nënligjore, udhëzimet dhe protokollat e nevojshme në mënyrë që të siguroni një sistem | 1.1. Plotësim ndryshimi i kornizës ligjore | Dhjetor 2024   | 12,500 €       | 0         | 0         | BK; Donatorët       | MSh                    | IKShPK                  | Ligji për parandalim dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse i aprovuar;<br><br>UA 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu |  |

|  |   |      |        |   |   |               |        |        |   |
|--|---|------|--------|---|---|---------------|--------|--------|---|
| mbikëqyrje të mirë funksionuar dhe efikas në përputhje me legjislacionin |   |      |        |   |   |               |        |        | <p>i aprovuar;</p> <p>UA 01/2019 për veprimtarinë, strukturën dhe funksionet e shërbimeve shëndetësore për HIV/AIDS i aprovuar;</p> <p>UA 05/2011 për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve spitalore i aprovuar</p> |
|  | 1.2. Hartimi i udhëzuesve dhe protokolleve që sigurojnë avancimin e sistemit mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitetëse | 2023 | 5000 € | 0 | 0 | BK; Donatorët | IKShPK | MSh/DL | Udhëzimet dhe protokollet e miratuara për avancim të sistemit të mbikëqyrjes  |

|   |  |                         |        |        |   |                      |               |                 |   |
|---|--|-------------------------|--------|--------|---|----------------------|---------------|-----------------|---|
